

حَصْرُ الْمُسْلِمِ

مِنْ أَذْكَارِ الْكِتَابِ وَالسُّنْنَةِ

MBUROJA E MUSLIMANIT

Me lutjet e kur'anit dhe
Sunnetit

Autor

Seid El-Kahtani



Përktheu
Rexhep lushta

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Parathënie

لِلَّهِ الْحَمْدُ لِلَّهِ نَحْمَدُهُ وَنَسْتَعِنُهُ وَنَسْتَغْفِرُهُ وَنَعُوذُ بِاللَّهِ مِنْ شُرُورِ أَنفُسِنَا
وَسَيِّئَاتِ أَعْمَالِنَا مَنْ يَهْدِي اللَّهَ فَلَا مُضِلٌّ لَهُ وَمَنْ يُضْلِلُ فَلَا هَادِي لَهُ وَأَشْهَدُ
أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَةٌ لَا شَرِيكَ لَهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّداً عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ أَمَّا
بَعْدُ:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنْتُمْ مُسْلِمُونَ﴾.

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا
وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسْأَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ إِنَّ
اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا﴾.

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا ﴿١٠﴾ يُصْلِحُ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ
وَيَغْفِرُ لَكُمْ ذَنْبَكُمْ وَمَنْ يُطِيعُ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا﴾.

Falënderimi i takon All-llahut, Atë e falënderojmë dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga All-llahu prej të këqijave të vvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon All-llahu, s'ka kush e lajthit, dhe kë e largon nga rruga e vërtetë Ai, s'ka kush e udhëzon. Dëshmoj se s'ka hyjni tjetër përvëç All-llahut, i Cili është Një dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i Dërguar i Tiji. Paqja dhe mëshira e All-llahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që i pasojnë këta me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

Ky është një version i shkurtër, i shkëputur prej librit tim:

الذِّكْرُ وَالدُّعَاءُ وَالْعِلَاجُ بِالرُّقُبِ مِنَ الْكِتَابِ وَالسُّنْنَةِ

"Edh-dhikru ved-du'au vel-iláxhu bir-ruká minel kitábi ves-sunneh", në të cilin kam nxjerré pjesën e dhikrit (lutjeve), që të jetë i lehtë për t'u bartur me vete, në çdo kohë dhe vend.

Jam përqendruar vetëm në tekstin e dhikrit, si dhe në përmendjen e një a dy burimeve kryesore, në të cilat gjendet origjinali, andaj kush dëshiron të ketë njoħuri rrēth sahabiat a nxjerrjes së hadithit, atëherë le t'i kthehet origjinalit.

E lus All-lahun e Lartë me emrat e Tij të bukur dhe cilësitet e Tij të larta, që ta bëjë këtë vepër të sinqertë, vetëm për hir të Fytyrës së Tij Fisnike. E lus që të më bëjë dobi mua në jetën time dhe mbas vdekjes sime, të ketë dobi ai i cili e lexon, e boton ose eshtë shkaktar në shpérndarjen e këtij libri, sepse me të vërtetë Ai eshtë pronar i kësaj dhe i Plotfuqishém.

Paqja dhe mëshira e All-lahut qofshin mbi të Dërguarin e Allahut (Muhammedin ﷺ), familjen, shokët e tij dhe mbi të gjithë tē tjerët që i pasojnë ata me tē mira deri në Ditën e gjykimit.

Seid el-Kahtani

VLERA E DHIKRITI

Përkujtimit të All-lahut [subhanehu ve teala].

All-lahu [subhanehu ve teala] thotë:

فَادْكُرُونِي أَذْكُرْكُمْ وَاشْكُرُوا لِي وَلَا تَكْفُرُونَ ﴿١﴾

"Më përkujtoni mua (me adhurim), Unë ju përkujtoju (me shpérblim), më falenderoni dhe mos më mohoni"!¹

﴿ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آتَيْنَا أَذْكُرْنَا لَكُمْ دِّينُنَا كَثِيرٌ ﴾²

"O ju që besuat, përkujtojeni All-lahun sa më shpesh!"²
﴿ وَالَّذِكْرُ كَثِيرٌ وَالذَّاكِرَاتِ أَعْدَ اللَّهُ لَهُمْ مَغْفِرَةً وَأَجْزًا عَظِيمًا ﴾.

"Për shumëpërmendësit e All-lahut dhe për shumëpërmendëset e All-lahut, All-lahu ka përgatitur falje (mëkatesh) dhe shpérblim të madh".³

﴿ وَإِذْكُرْ رَبَّكَ فِي نَفْسِكَ تَضَرَّعًا وَخِيفَةً وَدُونَ الْجَهْرِ مِنَ الْقُوَّلِ بِالْغُنْوِيِّ وَالْأَصَالِ وَلَا تَكُنْ مِنَ الْغَايِلِينَ ﴾

"Ti përmende Zotin tënd në vete (në heshtje), me respekt e me frikë, jo me shprehje të larta, (përmende) në mëngjes e në mbrëmje dhe mos u bëj prej atyre që nuk kanë kujdes".⁴

Pejgamberi ﷺ ka thënë: "Shembulli i atij që e bën dhikër Zotin e tij dhe i atij që nuk bën dhikër Zotin e tij,

¹ El-Bekare: 152

² El-Ahzab: 41.

³ El-Ahzab: 35.

⁴ El-A'rafë: 205.

është sikurse shembulli i të gjallit dhe i të vdekurit”.⁵ Në një rast tjetër, Pejgamberi ﷺ ka thënë: “A dëshironi t’ju tregoj për veprën tuaj më të mirë, më të dashur te Sunduesi juaj, me të cilën fitoni shpërbilimet më të larta tek Ai, veprën më të mirë sesa të shpenzoni ar dhe të holla (sadaka sh.p.) dhe më të mirë sesa ta luftoni armikun? A ta thanë: Po, si jo! (Pejgamberi ﷺ) Tha: Dhikri (Përkujtimi) i All-lahut.”⁶

Po ashtu, Pejgamberi ﷺ ka thënë: “All-lahu thotë: “Unë jam pranë robit tim ashtu si më mendon: nëse më përmend në vete, do ta përmend në veten Time, nëse më përmend në grup, do ta përmend në një grup më të mirë se ata, e nëse më afrohet një pëllëmbë, do t’i afrohem një krah, nëse më afrohet një krah, do t’i afrohem një pash, e nëse më vjen duke ecur, do t’i shkoj duke vrapuar.”⁷

Transmetohet nga Abdull-llah ibën Busri (Zoti qoftë i kënaqur me të) se një njeri ka thënë: “O i Dërguari i All-lahut, obligimet e fesë janë bërë shumë për mua (ngarkesë e tepërt),⁸ andaj më trego diç së cilës do t’i përbahem. Pejgamberi ﷺ i tha: Le të jetë gjuha jote gjithmonë e njomë nga dhikri i All-lahut”.⁹

⁵ Fet-hul Bari 11/208 dhe Muslimi 1/539, me këtë version: [Shembulli i shtëpisë në të cilën përmendet All-lahu dhe i shtëpisë në të cilën nuk përmendet All-lahu është sikurse shembulli i të gjallit dhe i të vdekurit].

⁶ Transmeton Tirmidhiu 5/459, Ibën Maxheh 2/1245 (Sahih Ibën Maxheh 2/316 dhe Sahih Et-Tirmidhiu 3/139).

⁷ Transmetojnë Buhariu 8/171 dhe Muslimi 4/2061.

⁸ Shënim i përkthyesit.

⁹ Tirmidhiu 5/458, Ibën Maxheh 2/1246, (Sahih Et -Tirmidhi 3/139 dhe Sahih Ibën Maxheh 2/317).

Për dhikrin Pejgamberi ﷺ ka thënë edhe këtë: “Kush e lexon një shkronjë nga Libri i All-llahut (Kur’ani), ai do të ketë për atë një shpërblim të mirë, dhe dhjetë herë aq. Nuk them: “Elif Lam Mim” një shkronjë, por “Elif” një shkronjë, “Lam” një shkronjë, “Mim” një shkronjë”.¹⁰

Transmetohet nga Ukbetu ibën Amir (Zoti qoftë i kënaqur me të), i cili thotë: “Doli i Dërguari i All-lahut ﷺ derisa ne ishim në Suffetu, dhe tha: “Kush nga ju dëshiron të shkojë për çdo ditë deri në luginën But-han ose El-akik dhe të kthehet nga ajo me dy deve të mëdha”? Ne i thamë: “O i Dërguari i All-lahut, ne vërtet e dëshirojmë këtë!” Ai na tha: “A nuk shkon ndonjëri nga ju në xhami që ta mësojë dikë, ose t’i lexojë dy ajete prej librit të All-lahut? Kjo janë më të vlefshme për të sesa dy deve, tri (ajete) janë më të vlefshme se tri (deve), katër (ajete) janë më të vlefshme se katër (deve). Pra, më të vlefshme se devet me po të njëjtin numër”!¹¹

Pejgamberi ﷺ ka thënë: “Kush ulet në një vend dhe nuk e përmend aty All-lahun, atë do ta godasë përbuzja e All-lahut, dhe kush mbështetet në shtrat dhe nuk e përmend All-lahun, atë do ta godasë përbuzja e All-lahut”.¹²

Pejgamberi ﷺ ka thënë: “S’është ulur një popull në një tubim në të cilin nuk është përmendur All-lahu dhe nuk i është dërguar përshtendetje (salavat) të Dërguari të

¹⁰ Tirmidhiu 5/175, (Sahih Et-Tirmidhi 3/9 dhe Sahihul- xhamiu 5/340).

¹¹ Muslimi 1/553.

¹² Transmeton Ebu Davudi 4/264 dhe të tjera, (Sahihul-Xhamiu hadithi nr: 6477).

tyre, vetëm se i ka kapluar ata përbuzja e All-lahut, nëse dëshiron i dënon e nëse dëshiron ua fal".¹³

Dhe thotë Pejgamberi ﷺ: "Ata njerëz që ngrihen nga një tubim ku nuk e përmendin All-lahun [subhanehu ve teala], s'janë ngritur ndryshe vetëm sikur të ishin një trup i ngordhur gomari dhe kështu kanë dështuar".¹⁴

1- Ç'DUHET THËNË KUR TË ZGJOHEMI NGA GJUMI

(1)

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَخْيَانَا بَعْدَ مَا أَمَاتَنَا وَإِلَيْهِ التَّشْوُرُ.

El-hamdu lil-láhil-ledhí ahjáná ba'de má emátená ve ilejhin-nushúr.

(Falënderimi i qoftë All-lahut, i Cili na ringjalli pasi që na bëri të vdekur, dhe te Ai eshtë tubimi)¹⁵

(2)

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَةٌ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَبِيرٌ، سُبْحَانَ اللَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ الْعَلِيِّ الْغَفِيلِ. رَبُّ اغْفِرْ لِي

Lá ilahé il-lAll-lahu vahdehu la sherike leh, lehul-mulku ve lehul-hamdu ve huve alá kul-li shejin kadir. Subhán-All-lah vel-hamdu lil-lah ve lá iláhé il-laAll-lah vAll-lahu Ekber ve lá havle ve lá kuvvete il-lá bil-láhil Alíjjil Adhím. "All-lahummagfir li.

¹³ Transmeton Tirmidhiu (*Sahih Et-Tirmidhi* 3/140).

¹⁴ Transmetojnë Ebu Davudi 4/264 dhe Ahmed 2/389, (*Sahihul-Xhamiu* 5/176).

¹⁵ Transmetojnë Buhariu (*Fet-hul Bari* 11/113) dhe Muslimi 4/2083.

(S'ka tē adhuruar tjetër përvèç All-lahut Një dhe tē Pashoq, Atij i takon Sundimi dhe Lavdërimi dhe Ai eshtë i Plotfuqishëm mbi çdo send. I Madhërishëm qoftë All-lahu, Falënderimi i takon All-lahut, s'ka tē adhuruar tjetër përvèç All-lahut, All-lahu eshtë më i Madhi, s'ka ndryshim e as fuqi pa ndihmën e All-lahut tē Lartmadhërishëm, - pastaj lutet dhe thotë: "O Zoti im, më fal")¹⁶

(3)

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي عَافَانِي فِي جَسَدِي وَرَدَ عَلَيَّ رُوحِي وَأَذِنَ لِي بِذِكْرِهِ.

El-hamdu lil-láhil-ledhí á fáni fi xhesedi ve redde alejje rúhi ve edhine lí bi dhikrihi.

(Falënderimi i qoftë All-lahut, i Cili ma mbrojti trupin tim, ma ktheu shpirtin tim dhe ma mundësoi që ta përmend Atë)¹⁷

(4)

﴿إِنَّ فِي خَلْقِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاحْتِلَافِ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ لِآيَاتِ لَأُولَئِكَ الْأَلْبَابِ، الَّذِينَ يَذْكُرُونَ اللَّهَ قِيَامًا وَقَعْدًا وَعَلَى جُنُوبِهِمْ وَيَتَفَكَّرُونَ فِي خَلْقِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ رَبَّنَا مَا خَلَقْتَ هَذَا بَاطِلًا سُبْحَانَكَ فَقَدْ عَذَابُ النَّارِ رَبَّنَا إِنَّكَ مَنْ تُنْخِلُ النَّارَ فَقَدْ أَخْرَتَهُ وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ﴾ رَبَّنَا إِنَّا سَمِعْنَا مَنَادِي يَنَادِي لِلْإِيمَانِ أَنْ ءَامِنُوا بِرَبِّكُمْ فَأَمَّا رَبَّنَا فَاغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا

¹⁶ Kush e thotë këtë, do t'i falen mëkata, e nëse lutet do t'i pranohet lutja, e nëse ngrihet e merr abdes dhe falet, do t'i pranohet namazi. Transmetojnë Buhariu (*Fet-hul Bari* 3/39) dhe tē tjerë. Hadithin me këtë version e transmeton edhe Ibën Maxheh (*Sahih Ibën Maxheh* 2/235).

¹⁷ Tirmidhiu 5/473 (*Sahih Et-Tirmidhi* 3/144).

وَكَفَرُوا عَنِ سَيِّئَاتِهَا وَتَوَقَّنَا مَعَ الْأَبْرَارِ ﴿١﴾ رَبَّنَا وَإِنَّا مَا وَعَدْنَا عَلَى رُسُلِكَ
وَلَا تُخْزِنَا يَوْمَ الْقِيَامَةَ إِنَّكَ لَا تُخْلِفُ الْمِيعَادَ ﴿٢﴾ فَاسْتَجَابَ لَهُمْ رَبُّهُمْ أَنِّي لَا
أُصْبِحُ عَمَلًا مِنْكُمْ مَنْ ذَكَرَ أَوْ أَنْتَ بِعَضْنَكُمْ مَنْ بَعْضُ فَالَّذِينَ هَاجَرُوا
وَأَخْرَجُوا مِنْ دِيَارِهِمْ وَأُوذِنُوا فِي سَبِيلِي وَقَاتَلُوا وَتَقْتُلُوا لِأَكْفَارٍ عَنْهُمْ
سَيِّئَاتِهِمْ وَلَا دُخْلَنَّهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ ثَوَابًا مِنْ عِنْدِ اللَّهِ وَاللَّهُ
عِنْدَهُ حُسْنُ الْثَوَابِ ﴿٣﴾ لَا يَغُرُّكَ تَقْلُبُ الَّذِينَ كَفَرُوا فِي الْبَلَادِ ﴿٤﴾ مَتَاعٌ
قَلِيلٌ ثُمَّ مَأْوَاهُمْ جَهَنَّمُ وَبَشِّنَ الْمَهَادِ ﴿٥﴾، لَكِنَّ الَّذِينَ اتَّقَوْا رَبُّهُمْ لَهُمْ جَنَّاتٍ
تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا نُزُلًا مِنْ عِنْدِ اللَّهِ وَمَا عِنْدَ اللَّهِ خَيْرٌ
لِلْأَبْرَارِ ﴿٦﴾ وَإِنَّ مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ لَمَنْ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَمَا أُنْزَلَ إِلَيْكُمْ وَمَا أُنْزَلَ
إِلَيْهِمْ خَاطِعِينَ لِلَّهِ لَا يَشْتَرِونَ بِنَيَّاتِهِمْ ثُمَّا قَلِيلًا أُولَئِكَ لَهُمْ أَجْرٌ هُمْ عِنْدَ
رَبِّهِمْ إِنَّ اللَّهَ سَرِيعُ الْحِسَابِ ﴿٧﴾ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ظَاهَرُوا أَصْبِرُوا وَصَابِرُوا
وَرَأَبِطُوا وَاتَّقُوا اللَّهَ لَعَلَّكُمْ تُنْلَحُونَ﴾.

"Me të vërtetë, në krijimin e qiejeve dhe të tokës dhe në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente për ata që kanë arsyë dhe intelekt. Për ata që e përmendin All-lahun me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rrëth krijimit të qiejeve e të tokës, (duke thënë):" Zoti ynë, këtë nuk e krijoje kot, i Madhërishtëm qofsh, na ruaj prej dënimit të zjarrit! Zoti ynë, atë që Ti e fute në zjarr, atë e ke poshtëruar; për mizorët nuk ka ndihmëtarë! Zoti ynë, ne dëgjuam një thirrës që ftonte për besim (e që thoshte): "Besojeni Zotin tuaj! E ne besuam!"

Zoti ynë, na i fal mëkatet tona dhe pas vdekjes na bashko me të mirët!" "Zoti ynë, na jep atë që nëpërmjet të dërguarve të Tu na e premtovë dhe mos na turpëro në

Ditën e Kijametit; vërtet Ti je Ai që nuk e shkel p rem-timin. Zoti iu përgjigji lutjes së tyre (e tha): "Unë nuk ia humb mundin asnjerit prej jush, mashkull qoftë a femër. Ju jeni nga njëri-tjetri, por ata që u dëbuani nga shtëpitë e tyre dhe emigruan, u munduan vetëm pse ishin në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, atyre do t'ua shlyej mëkatet e tyre dhe do t'i fus në Xhennete ku burojnë lumenj. Ai është shpërblim nga All-lahu, se shpërblimi më i mirë është tek All-lahu. T'ju mos mashtrojë breshja nëpër qytetet e atyre që nuk besuan. Ajo është një kënaqësi e pakët, e pastaj vendi i tyre është Xhehennemi, që është vend mjerimi. Por ata që ia patën frikën Zotit të tyre, ata i kanë Xhennetet ku rrjedhin lumenj dhe aty janë përgjithmonë. Ajo është një pritje nga All-lahu, e për të mirët, më e dobishmja është ajo që është tek All-lahu. Po edhe nga ihtarët e librit ka që e besojnë All-lahun, e besojnë atë që ju është shpallur juve dhe atë që u është shpallur atyre. Janë të bindur ndaj All-lahut, dhe argumentet e All-lahut (në shpallje) nuk i shesin për pak send të kësaj jete. Të tillët kanë shpërbimin e vet tek Zoti i tyre, e All-lahu është që llogarinë e bën s hpejt. O ju besimtarë, bëni durim, bëhuni të qëndrueshëm kundër armikut, rrini të përgatitur dhe frikojuni All-lahut, nëse dëshironi të shpëtoni!"¹⁸

2- DUAJA KUR TË VESHIM NDONJË RROBË

(5)

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي كَسَانِي هَذَا (الثُّوبَ) وَرَزَقَنِي مِنْ غَيْرِ حَوْلِ مِنِي وَلَا قُوَّةٍ.

¹⁸ Ali Imran: 190-200, Transmeton Buhariu (Fet-hul Bari 8/237), Muslimi 1/530.

El-hamdu lil-láhil-ledhí kesáni hádhá (eth-thevbe) ve rezekanihi min gajri havlin minní ve lá k `uvvetin.

(*Falénderimi i qoftë All-lahut, i Cili ma mundësoi ta vesh këtë rrobë dhe më furnizoi me këtë pa ndihmën dhe fuqinë time*)¹⁹

3-DUAJA KUR TË VESHIM NDONJË RROBË TË RE

(6)

اللَّهُمَّ لَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ كَسْوَتِيهِ أَسْأَلُكَ مِنْ خَيْرِهِ وَخَيْرٌ مَا صَنَعَ لَهُ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّهِ وَشَرٌّ مَا صَنَعَ لَهُ.

All-lahumme lekel-hamdu ente kesevtenihi, es-eluke min hajrihi, ve hajri má suni-a lehú, ve eúduhu bike min sherrihi ve sherri má suni-a lehú.

(O Zoti im, Ty të qoftë falénderimi, Ti je Ai i Cili më furnizove me këtë, Të lutem, ma dhuro të mirën e saj dhe të mirën për çfarë është punuar. Kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja e saj dhe (nga) e keqja për çfarë është punuar ajo)²⁰

4-DUAJA PËR ATË QË VESH RROBA TË REJA

(7)

بِسْمِ اللَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

Tublí ve juhlifullahu teálá.

¹⁹ Transmetojnë: Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ibën Maxheh (Irval-Galil 7/47).

²⁰ Transmetojnë: Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Begaviu. (Muhtesar Shemail Et-Tirmidhi të autorit Nasiruddin El-Albani fq. 47).

(*E shtjerrsh dhe All-lahu ta zavendësoftë me tjetër*)²¹

(8)

الْبَسْنَ جَيْدًا وَعِشْ حَيْدًا وَمَتْ شَهِيدًا.

Ilbis xhediden ve ish hamiden ve mut shehiden.

(*Vishe të re, jeto me dinjitet dhe vdis shehid (dëshmor në rrugën e All-lahut)*)²²

5- Ç'DUHET THËNË KUR E HEQIM RROBËN

(9)

بِسْمِ اللَّهِ.

Bismil-lah.

(*Me emrin e All-lahut*)²³

6- DUAJA PARA HYRJES NË NEVOJTORE

(10)

(بِسْمِ اللَّهِ) اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْخَبُثِ وَالْخَبَاثَ.

[*Bismil-lah*] *All-láhumme inní e úduhu bike minel-hubthi vel-habáithi.*

(*Me emrin e All-lahut, O Zot kërkoj mbrojtjen Tënde nga djalli dhe djallja dhe nga çdo vepër e ndytë*)²⁴

²¹ Transmeton: Ebu Davudi 4/41 (*Sahih Ebu Davud* 2/760).

²² Transmetojnë: Ibën Maxheh 2/1178 dhe Begaviu 12/41 (*Sahih Sunen Ibën Maxheh* 2/275).

²³ Transmetojnë: Tirmidhiu 2/505 dhe të tjerë (Irval-Galil Nr: 49 dhe Sahihul-Xhamiu hadithi Nr: 3/203).

²⁴ Transmetojnë: Buhariu 1/45 dhe Muslimi 1/283, shtojcën (*Bismil-lah*) në fillim të hadithit e transmeton Seid ibën Mensuri (*Fet-hul-Bari* 1/244).

7- DUAJA PAS DALJES NGA NEVOJTORJA

(11)

غُفرانك.

Gufráneke.

(Kérkoj faljen Tënde o Zot)²⁵

8- DHIKRI PARA ABDESIT

(12)

بِسْمِ اللَّهِ.

Bismil-láh

9- DHIKRI PAS PËRFUNDIMIT TË ABDESIT

(13)

أشهدُ أَنَّ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ وَأَشْهُدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ.

*Esh-hedu en lá Iláhe il-lAlláhu vahdehu lá sherike lehu
ve esh-hedu enne Muhammeden abduhú ve resúluhú.*

(Dëshmoj se nuk ka tē adhuruuar tjetër përveç All-llahut
Një, i Vetëm dhe i Pashoq, dhe dëshmoj se Muhammedi
është rob dhe i Dërguar i Tij)²⁶

(14)

²⁵ Transmetojnë autorët e katër Suneneve, përveç Nesaiut i cili këtë hadith e transmeton në librin e tij "Amelul-jevmi vel-lejleti" (Zadul-Mead 2/387).

²⁶ Transmeton Muslimi 1/209.

اللَّهُمَّ اخْلُنِي مِنَ التَّوَابِينَ وَاجْلُنِي مِنَ الْمُتَطَهِّرِينَ.

All-llahumme-xh-alní minet-tevvábíne ve-xh-alní minel-mutetahirín.

(O Zoti im, më bëj mua prej atyre që pendohen dhe më bëj mua prej atyre të cilët pastrohen)²⁷

(15)

سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ أَشْهُدُ أَنَّ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ أَسْتَغْفِرُكَ وَأَتُوبُ إِلَيْكَ

Subháneke All-llahumme ve bihamdike, Esh-hedu en lá iláhe il-lá Ente estagfiruke ve etíbu ilejke.

(I Madhérishëm je Ti o All-lahu im, Ty tē takon Falënderimi; dëshmoj se nuk ka tē adhuruuar tjetër përveç Teje, kérkoj falje nga Ti dhe te Ti pendohem.)²⁸

10- DHIKRI GJATË DALJES NGA SHTËPIA

(16)

بِسْمِ اللَّهِ، تَوَكَّلْتُ عَلَى اللَّهِ وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ.

Bismil-lah, tevekkeltu ala-All-láhi, ve lá havle ve lá kuvvete il-lá bil-lah.

(Me emrin e All-llahut, në All-llahun u mbështeta dhe s'ka lëvizje e as forcë përveçse me dëshirën e All-llahut.)²⁹

(17)

²⁷ Transmeton Tirmidhiu 1/78, Sahih Et-Tirmidhi 3/151.

²⁸ Transmeton Nesaiu në librin e tij (Amelul-jevmi vel-lejleti sq.173), (Irval-Galil 1/135 dhe 2/94).

²⁹ Transmetojnë: Ebu Davudi 4/325, Tirmidhiu 5/490 (Sahih Et-Tirmidhi 3/151).

(19)

اللَّهُمَّ اجْعِلْ فِي قَلْبِي نُورًا، وَفِي لِسَانِي نُورًا، وَفِي سَمْعِي نُورًا، وَفِي
بَصَرِي نُورًا، وَمِنْ فَوْقِي نُورًا وَمِنْ تَحْتِي نُورًا، وَعَنْ يَمِينِي نُورًا، وَعَنْ
شَمَالِي نُورًا، وَمِنْ أَمَامِي نُورًا وَمِنْ خَلْفِي نُورًا، وَاجْعِلْ فِي نَفْسِي نُورًا
وَأَعْظَمْ لِي نُورًا، وَعَظَمْ لِي نُورًا، وَاجْعِلْ لِي نُورًا، وَاجْعَلْنِي نُورًا، اللَّهُمَّ
أَعْطِنِي نُورًا، وَاجْعِلْ فِي عَصْبَيِّي نُورًا، وَفِي لَحْمِي نُورًا، وَفِي دَمِي نُورًا،
وَفِي شَعْرِي نُورًا، وَفِي بَشَرِي نُورًا.

All-lláhumme-xh' al fi kalbi nüren, ve fi lisaní nüren, ve fi
sem'i nüren, ve fi besarı nüren, ve min sevki nüren, ve
min tahti nüren, ve an jemini nüren, ve an shimali nüren,
ve min emámi nüren, ve min halfi nüren, ve-xh' al fi nefsi
nüren, ve a'dhim li nüren, ve 'adh-dhim li nüren, ve-
xh' al-li nüren, ve-xh' alni nüren, All-lláhumme aëtini
nüren, ve-xh' al fi asabi nüren, ve fi lahmí nüren, ve fi
demí nüren ve fi sha'ri nüren ve fi besheri nüren.

(O Zoti im, më jep dritë në zemrën time, në gjuhën time,
në të dëgjuarit tim, në të parët tim, më bëj dritë përmbi
mua, edhe nën mua, nga ana ime e djathtë dhe nga ana
ime e majtë, para dhe prapa, më bëj dritë në veten time,
ma madhështo mua dritën dhe ma zmadho mua dritën,
më jep mua dritë dhe më ndriço mua. O Zoti im, më jep
mua dritë, m'i ndriço venat e mia, ma ndriço mishin tim,
gjakun tim, m'i ndriço flokët dhe lëkurën time).³²

(اللَّهُمَّ اجْعِلْ لِي نُورًا فِي قَبْرِي.. وَنُورًا فِي عَظَمَاتِي)

³⁰ Transmetojnë autorët e katër Suneneve, (Sahih Et-Tirmidhi 3/153,
Sahih Ibën Maxheh 2/336).

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ أَنْ أَضِلَّ، أَوْ أَضِلَّ، أَوْ أَرِزَّ، أَوْ أَرِزَّ أَوْ أَظْلَمْ أَوْ أَظْلَمْ،
أَوْ أَجْهَلْ أَوْ يَجْهَلْ عَلَيَّ.

All-llahumme inní e údhu bike en edil-le ev udal-le, ev
ezil-le ev uzel-le, ev adhlime ev udhleme, ev exh-hele ev
juxh-hele alejje.

(O Zoti im, kërkoj mbrojtjen Tënde që të mos shkoj në humbje
[dalalet], e as dikush të mos më dërgojë në humbje [dalalet];
kërkoj mbrojtjen Tënde të mos lajthis [nga e vërteta]; kërkoj
mbrojtjen Tënde që të mos e dëmtoj askënd, e as dikush të mos
më dëmtojë mua; kërkoj mbrojtjen Tënde që të mos e shpërfill
askënd, e as dikush të mos më shpërfill mua)³⁰

11- DHIKRI GJATË HYRJES NË SHTËPI

(18)

بِسْمِ اللَّهِ وَلَجْنَا، وَبِسْمِ اللَّهِ خَرَجْنَا، وَعَلَى رَبِّنَا تَوَكَّلْنَا.

Bismil-láhi velexhná ve bismil-láhi harexhná ve alá
Rabbiná tevekkelná.

(Me emrin e All-llahut hyjmë dhe me emrin e All-llahut
dalim dhe te Zoti ynë mbështetemi). Pastaj pëershëndete
familjen tënde.³¹

³¹ Transmetojnë autorët e katër Suneneve, (Sahih Et-Tirmidhi 3/153,
Sahih Ibën Maxheh 2/336).

³¹ Transmeton Ebu Davudi 4/325, Ibën Bazi në librin e tij "Tuhfetul-
Ahjar" sq.28, dhe thotë: Senedi i këtij hadithi është i mirë, dhe
transmetohet në hadith të vërtetë se Pejgamberi ﷺ ka thënë: "Kur
njjeriu hyn në shtëpinw e tij dhe e përmend All-llahun gjatë hyrjes si
dhe gjatëngrënies së ushqimit

³² Transmetojnë Buhariu 11/116, Muslimi 1/526, 529, 530.

(وزِنْتِي نُورًا، وزِنْتِي نُورًا، وزِنْتِي نُورًا)

(وَهَبْ لِي نُورًا عَلَى نُورٍ)

All-lláhumme-xh' al-lí nüren fi kabri.., ve nüren fi idhámi.
[ve zidní nüren, ve zidní nüren, ve zidní nüren], [ve heb li
nüren alá nürin].

(O Zoti im, ma ndriço varrin tim dhe m'i ndriço eshtrat e
mia³³ dhe ma shto mua dritën, ma shto mua dritën, ma
shto mua dritën³⁴ dhe më dhuro mua dritë mbi dritë).³⁵

13- DUAJA GJATË HYRJES NË XHAMIA

(20)

أَعُوذُ بِاللَّهِ الْعَظِيمِ وَبِوَجْهِهِ الْكَرِيمِ وَسُلْطَانِهِ الْقَيْمِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ،

Eúduh bil-láhil-adhím ve bi vexhhihil-kerim ve sultánihil-kadim minesh-shejtánir-raxhím.

(Kérkoj nga All-lahu i Madhérishëm, me fytyrën e Tij të
ndershme dhe me fuqinë e Tij të pérhershme, të më
mbrojë nga djalli i mallkuar).³⁶

[بِسْمِ اللَّهِ، وَالصَّلَاةُ [وَالسَّلَامُ عَلَى رَسُولِ اللَّهِ].

Bismil-láh, ves-salátu ves-selámu alá resúlil-láh

³³ Transmeton Tirmidhiu 5/483.

³⁴ Transmeton Buhariu në librin El-Edebul-Musfred hadithi Nr-695
sq.258, isnadin e këtij hadithi e ka vërtetuar Albani në librin Sahihul-
Edebul-Musfred hadithi Nr-459.

³⁵ Këtë e ka përmendur Ibën Haxheri në Fet-hul Bari, dhe thotë se e
ka cekur këtë Ibën Ebi Asim në librin e duave, 11/118 dhe thotë nga
transmetimet e ndryshme janë përbledhur njëzet e pesë cilësi.

³⁶ Transmeton Ebu Davudi, (Sahihul-Xhamiu hadithi:) Nr-4591.

(Me emrin e All-llahut, përshëndetjet dhe shpëtimi³⁷
qofshin mbi të Dërguarin e All-llahut).

اللَّهُمَّ افْتَحْ لِي أَبْوَابَ رَحْمَتِكَ

All-lláhumme-stah li ebvábe rahmetike.

(O Zoti im, m'i hap dyert e mëshirës Sate).³⁸

14-DUAJA GJATË DALJES NGA XHAMIA

(21)

بِسْمِ اللَّهِ وَالصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ عَلَى رَسُولِ اللَّهِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنْ فَضْلِكَ،
اللَّهُمَّ اغْصِنْنِي مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ.

Bismil-lah ves-salátu ves-selámu 'alá resúlil-lah, All-
lláhumme inní es-eluke min fadlike, All-lláhumme
a 'ësimní minesh-shejtánir-rraxhím.

(Me emrin e All-llahut, l'utjet dhe përshëndetjet qofshin
mbi të Dërguarin e All-llahut. O Zoti im, të lutem të më
japësh prej të mirave të Tua.³⁹ O Zoti im, më mbroj nga
shejtani i mallkuar).⁴⁰

15- LUTJET E EZANIT

(22)

Duhet përsëritur atë që e thotë muezini, përveç kur thotë:

حَيٌّ عَلَى الصَّلَاةِ، وَحَيٌّ عَلَى الْفَلَاحِ

³⁷ Transmeton Ibën Sunij, hadithi: Nr-88, Albani thotë se hadithi është
i mirë, (hasen) Ebu Davudi 1/126, (Sahihul-Xhamiu 1/528).

³⁸ Transmeton Muslimi 1/494.

³⁹ Shih fusnotat nr: 37, 38.

⁴⁰ Transmeton Ibën Maxheh (Shih: Sahih Ibën Maxheh 1/129).

"Hajje ales-saláh, hajje alel feláh"

duhet thënë:

لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللهِ

Lá havle, ve lá kuvvete il-lá bil-lah.⁴¹

(23)

Gjithashtu duhet thënë edhe këtë:

وَإِنَا أَشْهَدُ أَن لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ وَأَنَّ مُحَمَّداً عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ
رَضِيَتِ اللَّهُ رَبِّا، وَبِمُحَمَّدٍ رَسُولاً وَبِالإِسْلَامِ دِينًا.

*Ve ene esh-hedu en Lá Iláhe il-lláhu vahdehú lá
sherike leh, ve enne Muhammeden abduhú ve resúluhú,
radiju bil-lahi Rabben ve bi Muhammedin resúlen, ve
bil-Islámi dínen.*

(Edhe unë dëshmoj se nuk ka tē adhuruar tjetër përvëç All-llahut Një dhe tē Pashoq, dhe se Muhammedi ް eshtë rob dhe i Dërguar i All-llahut; jam i kënaqur me All-llahun pér Zot, me Muhammedin pér Pejgamber dhe me Islamin pér fe).⁴² Këtë duhet thënë pasi tē thotë muezini: "Esh-hedu en lá Iláhe il-lallah, Esh-hedu enne Muhammeden Resúll-llah."⁴³

(24)

Pas përsëritjes së fjalëve tē muezinit, duhet tē çohen salavate mbi Pejgamberin ް.⁴⁴

(25)

⁴¹ Transmeton Buhariu 1/152, Muslimi 1/288.

⁴² Transmeton Muslimi 1/290.

⁴³ Transmeton Ibén Huzejme 1/220.

⁴⁴ Transmeton Muslimi 1/288.

Pas mbarimit tē ezanit duhet thënë:

اللَّهُمَّ رَبِّ هَذِهِ الدُّعَوَةِ التَّامَّةِ وَالصَّلَاةِ الْقَائِمَةِ أَتَ مُحَمَّداً الْوَسِيلَةَ وَالْفَضْلَةَ
وَابْنَتَهُ مَقَامًا مَحْمُودًا الَّذِي وَعَدْتَنَا إِنَّكَ لَا تَخْلُفُ الْمِيعَادَ.

*All-lláhumme Rabbe hádhihi ed-da 'vetit-támmeh ves-salátil-káiméh, áti Muhammedenil-vesilete vel-fadileh,
veb 'ath-hu mekámén mahmúden el-ledhí ve 'adteh, [inne-ke 'lá tuhliful-miád].*

*(O All-llahu im, Zot i kësaj thirrjeje tē plotë dhe i namazit që do tē falet, jepi Muhammedit ndërmjetësimin dhe
nderi-min dhe ngrije atë në vendin e lavdishëm tē cilin ia ke prentuar;⁴⁵ Me tē vërtetë Ti nuk e thyen premtimin.⁴⁶*

(26)

*"Bëj dua (lutu) pér vete ndërmjet ezanit dhe ikamitet,
sepse dua ja në këtë kohë nuk refuzohet."*⁴⁷

16- DUAJA NË FILLIM TË NAMAZIT

اللَّهُمَّ بَاعِدْ بَيْنِي وَبَيْنَ خَطَابَيِّ كَمَا بَاعَدْتَ بَيْنَ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ، اللَّهُمَّ
نَقِّنِي مِنْ خَطَابَيِّ كَمَا يُنقِّي التُّوبَ الْأَبْيَضُ مِنَ النَّسْ، اللَّهُمَّ اغْسِلْنِي مِنْ
خَطَابَيِّ بِالثَّلْجِ وَالْمَاءِ وَالْبَرِّ.

*All-lláhumme bá'id bejní ve bejne hatájáje kemá bá'adte
bejnel-meshriki vel-magrib, All-lláhumme nekkini min
hatájáje kemá junekká eth-thevbul-ebjedu mined-denesi,*

⁴⁵ Transmeton Buhariu 1/152.

⁴⁶ Këtë shtojcë tē hadithit e transmeton Bejhiku 1/410. Dijetari AbdulAziz Ibén Baz, sededin e këtij hadithi e ka bërë tē mirë (hasen) (Tuhfetul-Ahjar fq.38).

⁴⁷ Transmetojnë Tirmidhiu, Ebu Davudi dhe Ahmed, (Irvaul-Galil 1/262).

All-lláhumme Igsilní min hatájáje bil mái veth-thelxhi
vel-beredi.

(O Zoti im, më largo mua nga mëkatet e mia, ashtu siç e ke larguar lindjen nga perëndimi. O Zoti im, më pastro mua prej mëkateve të mia, ashtu sikur pastrohet rroba e bardhë nga njollat. O Zoti im, më pastro mua prej mëkateve të mia me ujë, borë dhe akull).⁴⁸

(28)

سْبَحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ وَتَبَارَكَ اسْمُكَ وَتَعَالَى جَدُّكَ وَلَا إِلَهَ غَيْرُكَ.

Subháneke All-lláhumme ve bihamdike ve tebárekesmuke ve teálá xhedduke ve lá Iláhe gajruke.

(I Lartë qofsh o Zoti im dhe pér Ty éshtië falënderimi, i Lartë qoftë emri Yt dhe e Lartë qoftë Madhëria Jote, s'ka tē adhuruuar tjetër pérveç Teje)⁴⁹

(29)

وَجَهْتُ وَجْهِي لِلَّذِي فَطَرَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ حَتِيفًا وَمَا أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ،
إِنَّ صَنْلَاتِي، وَنُسُكِي، وَمَحْيَايِي، وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ، لَا شَرِيكَ لَهُ
وَبِنِلَّكَ أَمْرَتُ وَأَنَا مِنَ الْمُسْلِمِينَ. اللَّهُمَّ أَنْتَ الْمَلَكُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ. أَنْتَ رَبِّي
وَأَنَا عَبْدُكَ، ظَلَمْتُ نَفْسِي وَاعْتَرَفْتُ بِذَنْبِي فَاغْفِرْ لِي ذُنُوبِي جَمِيعًا إِنَّهُ لَا
يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ. وَاهْنِي لِأَحْسَنِ الْأَخْلَاقِ لَا يَهْدِي لِأَحْسَنِهَا إِلَّا أَنْتَ
وَاصْرِفْ عَنِّي سَيِّئَهَا، لَا يَصْرِفْ عَنِّي سَيِّئَهَا إِلَّا أَنْتَ، لِيَكَ وَسَعْدِيَكَ،

وَالْخَيْرُ كُلُّهُ بِيَدِكَ، وَالشَّرُّ لَنْ يَلْقَى إِلَيْكَ. أَنَا بِكَ وَإِلَيْكَ تَبَارَكْتَ وَتَعَالَيْتَ
أَسْتَغْفِرُكَ وَأَتُوْبُ إِلَيْكَ.

Vexh-xhehtu vexh-hije lil-ledhi fetares-semáváti vel-erda hanífen ve má ene minel-mushrikín, inne saláti ve nusuki ve mahjáje ve memáti lil-láhi Rabbil-álemin lá sherike Lehú ve bi dhálike umirtu ve ene minel-muslimín. All-lláhumme Entel-Meliku lá Iláhe il-lá Ente. Ente Rabbi ve ene abduke, dhalemtu nefsi va 'terefstu bi dhenbi fagfir li dhunúbi xhemian innehú lá jagfirudh-dhunúbe il-lá Ente. Ve ihdini li Ahsenil-Ahláki lá jehdí li ahsenihá il-lá Ente, vesrif anni sejjiehá, lá jasrifu anni sejjiehá il-lá Ente, lebejke ve sa 'dejk, vel-hajru kul-luhú bi jedejke, vesh-sherru lejse ilejke, ene bike ve ilejke, tebárekte ve te álejt, estagfiruke ve etúbu ilejke.

(E ktheva fytyrén time me besim tē singertë nga Ai i Cili i ka krijuar qiejt dhe tokën dhe unë nuk jam nga idhujtarét. Me tē vërtetë namazi im, ibadeti (adhurimi) im, jeta dhe vdekja ime janë vetém pér All-llahun, Zotin e tē gjitha botërave. Nuk ka si Ai, kështu jam i urdhëruar dhe unë jam prej muslimanéve. O Zoti im, Ti je Sundimtar i çdo gjëje, s'ka tē adhuruuar pérveç Teje, Ti je Zoti im dhe unë jam robi Yt. I kam bérë dëm (zullum) vetes dhe i pranoj mëkatet e mia, pra m'i fal tē gjitha mëkatet, sepse mëkatet nuk i fal askush tjetër pérveç Teje. Më udhëzo mua në moralin më tē mirë, sepse në moralin më tē mirë nuk udhëzon askush tjetër pérveç Teje, dhe largo nga unë sjelljen (e moralin) e keqe, s'epse a tē s'e l'argon a skush tjetër pérveç Teje; Ty tē përgjigjem dhe Ty tē madhëroj; e gjithë e mira éshtië në duart e Tua, kurse e keqja s'ka vend te Ti (s'gjendet te Ti); ekzistenza dhe rikthimi im

⁴⁸ Transmeton Buhariu 1/181, Muslimi 1/419.

⁴⁹ Transmetojnë autorët e katér Suneneve, (Sahih Et-Tirmidhi 1/77, Sahih Ibën Maxheh 1/135).

janë në duart e Tua. I Madhérishëm dhe i Lartë je, kërkoj falje nga Ti dhe te Ti pendohem).⁵⁰

(30)

اللَّهُمَّ رَبَّ جِبْرِيلَ، وَمِيكَائِيلَ، وَإِسْرَافِيلَ فَاطِرِ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ، عَالَمَ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ أَنْتَ تَحْكُمُ بَيْنَ عِبَادِكَ فَيْمَا كَانُوا فِيهِ يَخْتَلِفُونَ。 اهْنِي لِمَا اخْتَلَفَ فِيهِ مِنَ الْحَقِّ بِإِذْنِكَ إِنَّكَ تَهْدِي مَنْ شَاءَ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ。

All-lahumme Rabbe Xhibráil ve Mikáil, ve Isráfil fátires-semáváti vel-erda, álimel-gajbi vesh-shehádeh, Ente takhumu bejne ibádike fi má kánú fihi jahtelisún. Ihdini limá ihtulise fihi minel-hakki bi idhnike inneke tehdi men tesháu ilá sirátin mustekim.

(O All-lahu im, Zot i Xhebrailit, Mikailit dhe Israfilit, Krijues i qiejve dhe i tokës, Ti je Ai që di tē fshehtat dhe tē dukshmet, Ti gjykon ndërmjet robërve tē Tu në atë që janë kundërshtuar, më udhëzo mua në tē vërtetën e asaj për çka janë kun-dërshtuar. Vërtet, Ti udhëzon në rrugën e drejtë atë që dëshiron).⁵¹

(31)

اللَّهُ أَكْبَرُ كَبِيرًا، اللَّهُ أَكْبَرُ كَبِيرًا، اللَّهُ أَكْبَرُ كَبِيرًا، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ كَثِيرًا، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ كَثِيرًا، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ كَثِيرًا، وَسَبَّحَنَ اللَّهُ بِكَرَّةٍ وَأَصْبَلَهُ أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ مِنْ نَفْخَهِ وَنَفَّثَهِ وَهَمْزَهِ。

All-lahu Ekberu Kebíren, All-lahu Ekberu Kebíren, All-lahu Ekberu Kebíren, vel-hamdu lil-láhi kethíren, vel-hamdu lil-láhi kethíren, vel-hamdu lil-láhi kethíren, ve

subhánAll-llahi bukreten ve esílen, (3 herë). Eúdu bil-láhi minesh-shejtáni: min nefshihi, ve nefshihi, ve hemzihi. (3 herë)

(All-llahu éshtë më i madhi, All-llahu éshtë më i madhi, All-llahu éshtë më i madhi, dhe falënderimi i shumtë i takon All-llahut, dhe i Madhérishëm qoftë All-llahu në mëngjes dhe mbrëmje (tre herë)

(Kërkoj mbrojtjen e All-llahut nga shejtani: nga kryelartësia e tij, nga poezia e tij dhe nga çmenduria e tij).⁵²

(32)

اللَّهُمَّ لَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ نُورُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ، وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ قَيْمُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ، [وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ رَبُّ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ] [وَلَكَ الْحَمْدُ لَكَ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ] [وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ مَلِكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ] [وَلَكَ الْحَمْدُ [أَنْتَ الْحَقُّ، وَوَعْدُكَ الْحَقُّ، وَقَوْلُكَ الْحَقُّ، وَلَقَاؤُكَ الْحَقُّ، وَالْجَنَّةُ حَقٌّ، وَالنَّارُ حَقٌّ، وَالنَّبِيُّونَ حَقٌّ، وَمُحَمَّدٌ حَقٌّ، وَالسَّاعَةُ حَقٌّ] [اللَّهُمَّ لَكَ أَسْلَمْتُ، وَعَلَيْكَ تَوَكَّلتُ، وَبِكَ آمَنتُ، وَإِلَيْكَ أَبْتَأْتُ وَبِكَ خَاصَّمْتُ وَإِلَيْكَ حَاكَمْتُ. فَاغْفِرْ لِي مَا قَدَّمْتُ، وَمَا أَخْرَتُ، وَمَا أَسْرَرْتُ، وَمَا أَعْلَنْتُ] [أَنْتَ الْمُقْدَمُ، وَأَنْتَ الْمُؤَخَّرُ، لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ] [أَنْتَ إِلَهِي لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ].

All-lahumme lekel-hamdu Ente Nurus-semáváti vel-erdi ve men fi hinne, ve lekel-hamdu Ente Kajjimus-semáváti vel-erdi ve men fi hinne [ve lekel-hamdu Ente Rabbus-semavati vel-erdi ve men fi hinne], [ve lekel-hamdu leke

⁵⁰ Transmeton Muslimi 1/135.
⁵¹ Transmeton Muslimi 1/534.
⁵² Transmetojnë Ebu Davudi 1/203, Ibën Maxheh 1/265 dhe Ahmedii 4/85, gjithashtu Muslimi transmeton njëloj me këtë 1/420.

Mulkus-semáváti vel-erdi ve men fi hinne], [ve lekel-hamdu Ente Málíkus-semáváti vel-erdi], [ve lekel-hamdu], [Entel-Hakku ve va'dukel-hakku, ve kavlukel-hakku, ve likáukel-hakku, vel-xhennetu hakkun, ven-náru hakkun, ven-nebjijjúne hakkun, ve Muhammedun hakkun, ves-sáatu hakkun], [All-llahumme leke eslemtu ve alejke tevekeltu, ve bike ámentu, ve ilejke enebtu, ve bike hásamtu, ve ilejke hákemtu, fagfirlí má kaddemu ve má ehartu, ve má esrertu ve má a'lentu], [Ennte el-Mukaddimu ve Ente el-Muah-hiru lá iláhe il-lá Ente], [Ente Iláhi lá iláhe il-lá Ente].

(O Zoti im, Ty tē takon falénderimi, Ti je Nuri (Drita) i qiejve dhe i tokës dhe i asaj ç'ka nē to, Ty tē takon falénderimi; Ti je ngritës i qiejve dhe i tokës dhe i asaj ç'ka nē to, Ty tē takon falénderimi; Ti je Zot i qiejve dhe i tokës dhe i asaj ç'ka nē to, Ty tē takon falénderimi; Yti éshtë Sundimi i qiejve dhe i tokës dhe i asaj ç'ka nē to, Ty tē takon falénderimi; Ti je Sundues i qiejve dhe i tokës, Ty tē takon falénderimi; Ti je i vërtetë dhe premtimi Yt éshtë i vërtetë, fjala Jote éshtë e vërtetë, takimi Yt éshtë i vërtetë, Xhenneti éshtë i vërtetë, Xhehennemi éshtë i vërtetë, Pejgamberët janë tē vërtetë, Muhammedi éshtë i vërtetë, Kijameti éshtë i vërtetë. O Zoti im, Ty tē jam nënshtuar dhe nē Ty jam mbështetur, Ty tē kam besuar dhe Ty tē drejtohem, pér Ty (urdhrat e Tua) hasmohem dhe te Ti kthehem pér gjykim, m'i fal mëkatet e mia e mëparshme dhe tē tanishmet, ato që i kam bëre fshehurazi dhe haptazi. Ti je i Pari dhe Ti je i Fundit, s'ka tē adhuruar tjeter pérveç teje; Ti je Zoti im, s'ka Zot tjeter pérveç Teje).⁵³

17- DUATË NË RUKU

(33)

⁵³ Transmetojnë Buhariu (Shih: Fet-hul Bari 3/3, 1/116, 13/371, 423, 465, Muslimi nē version tē shkurtuar njëloj me këtë 1/83.

سُبْحَانَ رَبِّيِ الْعَظِيمِ

Subháne Rabbijel-'adhím (3 herë).

(I Lartë qofshë Zoti im i Madhérishëm).⁵⁴

(34)

سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ رَبَّنَا وَبِحَمْدِكَ اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِنَا.

Subhanekë Allahumme Rabbenä ve bihamdike, Allahumme-gfirlı.

(I Lartë qofsh o All-lah, Zoti ynë, Ty tē takon falénderimi; O All-lah, më fal mua).⁵⁵

(35)

سُبُّوْخَ قُدُّوسَ رَبِّ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ.

Subbühun, Kudüsün Rabbul Meláiketi ver-Rúh.

(I Madhérishëm dhe i Shenjtë éshtë Zoti i melaikeve dhe i Xhibrilit).⁵⁶

(36)

اللَّهُمَّ لَكَ رَكِعْتُ وَبِكَ آمَنتُ، وَلَكَ أَسْلَمْتُ خَشَعْ لَكَ سَمْعِي، وَبَصَرِي، وَمَخْيِي، وَعَظَمِي، وَعَصِيَّيِي، وَمَا اسْتَقَلَّ بِهِ قَدْمِي.

All-llahumme leke reka'tu, ve bike ámentu, ve leke eslemtu, hashe'a leke sem'i ve besari, ve muhhi, ve a'dhmi, ve 'asabi ve mes-tekal-le bihi kademi.

(O Zot, Ty tē jam pérulur dhe Ty tē besova. Ty tē jam nënshtuar; Ty tē éshtë pérulur me frikë dëgjimi im,

⁵⁴ Transmetojnë pronarët e katër Suneneve dhe Ahmedî (Sahih Et-Tirmidhi 1/83).

⁵⁵ Transmetojnë Buhariu 1/99, Muslimi 1/350.

⁵⁶ Transmetojnë Muslimi 1/353, Ebu Davudi 1/230.

*shikimi im, truri im, ashti im, nervi im dhe gjithë ato që mbajnë këmbët e mia).*⁵⁷

(37)

سُبْحَانَ ذِي الْجَرُوتِ، وَالْمَلْكُوتِ، وَالْكَبْرِيَاءِ، وَالْعَظَمَةِ.

Subháne dhil-xheberúti vel-melekúti vel-kibrijái vel-adhameti.

(I Madhërishëm qoftë i Gjithëfuqishmi, Poseduesi i çdo sendi, Atij i takon Madhëria).⁵⁸

18-DUATË GJATË NGRITJES NGA RUKUJA

(38)

سَمِعَ اللَّهُ لِمَنْ حَمَدَهُ

Semi'All-lahu limen hamideh.

(All-lahu e dëgjon atë që e falënderon Atë)⁵⁹

(39)

رَبَّنَا وَلَكَ الْحَمْدُ حَمْدًا كَثِيرًا طَيِّبًا مُبَارِكًا فِيهِ.

Rabbená ve lekel-hamd, hamden kethiren tajjiben mubâreken fihi.

(Zoti ynë, Ty të takon falënderimi, falënderimi i shumtë, në të cilin është mirësia dhe bekimi).⁶⁰

(40)

⁵⁷ Transmetojnë Muslimi 1/534 dhe autorët e katër Suneneve, përvëç Ibën Maxhes.

⁵⁸ Transmeton Ebu Davudi 1/230, njësoj transmetojnë edhe Nesaiu dhe Ahmed; senedi i këtij hadithi është i mirë (hasen).

⁵⁹ Transmeton Buhariu (Fet-hul Bari 2/282).

⁶⁰ Transmeton Buhariu (Fet-hul Bari 2/282).

مِلْءُ السَّمَوَاتِ وَمِلْءُ الْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا وَمِلْءُ مَا شَيْءَ مِنْ شَيْءٍ بَعْدَهُ.
أَهْلُ النَّاءِ وَالْمَجْدِ أَحَقُّ مَا قَالَ النَّبِيُّ وَكُلُّنَا لَكَ عَنْدَهُ اللَّهُمَّ لَا مَانِعَ لِمَا أَغْطَيْتَ وَلَا مُغْطِي لِمَا مَنَعْتَ وَلَا يَنْفَعُ ذَا الْجَدَّ مِنْكَ الْجَدُّ.

Mil`es-semáváti ve mil`el-erdi ve má bejnehumá, ve mil`e má shi`te min shejin ba`edu. Ehleth-thendai vel-mexhdi, ehakku má kálel-'abdu, ve kul-luná Leke 'abdun. All-lahumme lá máni'a limá a'etajte, ve lá mu'etije limá mena'ete, ve lá jenfe'u dhel-xheddi minkel-xheddu.

(Ty të qoftë falënderimi sa qiejt dhe toka dhe sa ka ndërmjet tyre dhe aq sa Ti dëshiron prej gjérave të tjera. O pronar i Lavdisë dhe i Madhështisë, Ti meriton lavdi dhe madhështi më shumë se ç'thotë robi Yt, dhe të gjithë ne jemi robërit e Tu: O Zoti im, s'ka kush e ndalon atë që Ti e jep, s'ka kush e jep atë që Ti e ndalon; s'ka dobi i pasuri, pasuria e të cilit është prej teje (por dobi bën besimi dhe respekti Yt)⁶¹)

19-DUATË NË SEXHDE

(41)

سُبْحَانَ رَبِّ الْأَعْلَى.

Subháne Rabbijel-a'lá, (3 herë).

(I Madhërishëm qoftë Zotin im i Lartë)⁶²

(42)

سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ رَبَّنَا وَبِحَمْدِكَ اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي.

⁶¹ Transmeton Muslimi 1/346.

⁶² Transmetojnë autorët e katër suneneve dhe Ahmed (Sahih Et-Tirmidhi 1/83).

Subháneke All-llahumme Rabbená ve bihamdike, All-llahumme-gfirlí.

(I Madhérishém qofsh o All-llah, Zoti ynë, Ty tē takon falénderimi; O All-llah, më fal mua).

(43)

سُبُّوْخْ قُلُوسْ رَبُّ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ.

Subbúhun, Kudúsun Rabbul Meláiketi ver-Rúh.

(I Madhérishém dhe i Shenjtë éshtë Zoti i melaikeve dhe i Xhibrilit).⁶⁴

(44)

اللَّهُمَّ لَكَ سَجَّنْتُ وَبِكَ آمَنْتُ، وَلَكَ أَسْلَمْتُ سَجَّدَ وَجْهِي لِلَّذِي خَلَقَ وَصَوَّرَهُ
وَشَقَّ سَعْنَةً وَبَصَرَهُ تَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ.

All-llahumme Leke sexhed-dtu ve bike ámentu ve Leke eslemtu, sexhede vexh-hije lil-ledhí halekahu, ve savverehu ve shekka sem'ahú ve besarehú, tebárek All-lahu Ahsenul-Hálikin.

(O Zoti im, Ty tē kam bérë sexhde, Ty tē besova, Ty tē jam nénshtruar, fytyra ime i bén sexhde Atij i Cili e ka krijuar d he e ka z bukuruar d he q ē i a ka krijuar v eshët dhe sytë, i Madhérishém qofsté All-lahu, Krijuesi më i Mirë)⁶⁵

(45)

سُبْحَانَ ذِي الْجَبَرُوتِ، وَالْمَلْكُوتِ، وَالْكِبْرَيَاءِ، وَالْعَظَمَةِ.

Subháne dhil-xheberúti vel-melekúti vel-kibrijái vel-adhameti.

⁶³ Transmetojnë Buhariu 1/99, Muslimi 1/350.

⁶⁴ Transmetojnë Muslimi 1/353, Ebu Davudi 1/230.

⁶⁵ Transmeton Muslimi 1/534 dhe tē tjerët.

(I Madhérishém qofsté i Gjithëfuqishmi, Poseduesi i qdo sendi, Atij i takon Madhëria).⁶⁶

(46)

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي ذَنْبِي كُلَّهُ، بِقَهْ وَجْلَهُ، وَأُولَئِنَّهُ وَآخِرَةً وَعَلَانِيَّةَ وَسِرَّهُ.

All-llahumme-gfir li dhenbi kul-lehú, dikkahu ve xhil-lehu, ve evvelehu ve áhirehu ve 'alánijetehú ve sirrehu.

(O Zoti im, m'i fal mua tē gjitha mëkatet e mia, tē voglat dhe tē mëdhatë, tē parat dhe tē fundit, që i kam bérë haptas apo fsheetas).⁶⁷

(47)

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِرِضَاكَ مِنْ سُخْنَكَ، وَبِمَعَافَاتِكَ مِنْ عَوْبِتِكَ وَأَعُوذُ بِكَ
مِنْكَ، لَا أَخْصِي شَاءَ عَلَيْكَ أَنْتَ كَمَا أَثْبَتَ عَلَى نَفْسِكَ.

All-llahumme inní e 'údu bi ridáke min sehatik, ve bi muáfátike min 'ukúbetik, ve e 'údu bike minke, lá uhsí thenáen Alejke, Ente kemá ethneje alá Nefsike.

(O Zoti im, kérkoj strehim me anë tē kënaqësisë Sate nga hidhërimi Yt dhe me faljen Tënde nga dënimí Yt. Kérkoj mbrojtjen Tënde nga Ti, unë nuk mund tē tē madhëroj siç e meriton Ti; Ti je i Madhérishém ashtu siç e ke pérshkruar Veten).⁶⁸

20-DUATË NË ULJEN NDËRMJET DY SEXHDEVE

(48)

رَبُّ اغْفِرْ لِي، رَبُّ اغْفِرْ لِي.

⁶⁶ Transmeton Ebu Davudi 1/230, gjithashtu transmetojnë edhe Nesaiu dhe Ahmed; senedi i këtij hadithi éshtë i mirë.

⁶⁷ Transmeton Muslimi 1/350.

⁶⁸ Transmeton Muslimi 1/532.

Rabbi-gfırılı, Rabbi-gfir li
(O Zoti im, më fal mua. O Zoti im, më fal mua!)⁶⁹

(49)

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي، وَارْحَمْنِي، وَاهْدِنِي، واجْبَرْنِي، وَعَافِنِي وَارْزَقْنِي.
وارْقَعْنِي.

All-llahumme-gfir lí ver-hamní, ve-hdini, vexh-burní, ve
áfiní ver-zukní, ver-f'aní.

(O Zoti im, më fal, më mëshiro, më udhézo, më forco (në
këtë fe), më jep shëndet, më jep furnizim!)⁷⁰

21-DUATË E SEXHDES ME RASTIN E LEXIMIT TË KUR'ANIT

(50)

سَجَدَ وَجْهِي لِلَّذِي خَلَقَ وَشَقَ سَمْعَةً وَبَصَرَةً بِحَوْلِهِ وَقُوَّتِهِ فَتَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ .

Sexhede vexhhije lil-ledhi halekahu ve shekka sem'ahu ve
besarehu bi havlihi ve kuvvetihi [Fetebarek-All-llahu
Ahsenul-Halikin].

(Fytyra ime i bën sexhde Atij i Cili e ka krijuar dhe në të
ka formuar të dëgjuarit dhe të parët me pushtetin dhe

fuqinë e Tij; i Madhérishëm qoftë All-llahu, Krijuesi më i
Mirë.)⁷¹

(51)

اللَّهُمَّ اكْتُبْ لِي بِهَا عِنْدَكَ أَجْرًا، وَضَعْ عَنِّي بِهَا وِزْرًا وَاجْعَلْهَا لِي عِنْدَكَ
ذُخْرًا، وَتَقْبِلْهَا مِنِّي كَمَا تَقْبَلْتَهَا مِنْ عِنْدِكَ دَأْوَدْ.

All-llahumme uktub li biha 'indeke exhren, ve da 'anni
biha vizren, vexh'alha li 'indeke dhuhren, ve tekabbelha
minni kema tekabbelteha min 'abdike Davud.

(O Zoti im, më shkruaj mua me këtë (sexhde) shpërblim te
Ti dhe largoji nga unë mëkatet dhe ma bëj këtë që të kem
dobi te Ti dhe ma prano mua këtë, sikur e ke pranuar prej
robit tënd Davudit)⁷²

22-TESHEH-HUDI

(52)

الْتَّحَيَّاتُ لِلَّهِ وَالصَّلَوَاتُ وَالطَّيَّاتُ ، السَّلَامُ عَلَيْكَ أَلَّهُ النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللهِ
وَبَرَكَاتُهُ، السَّلَامُ عَلَيْنَا وَعَلَى عِبَادِ اللهِ الصَّالِحِينَ. أَشْهُدُ أَنَّ لا إِلَهَ إِلَّا اللهُ
وأشهُدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ .

Et-tehijatu lil-lahi ves-salavatu vet-tajjibatu, es-selamu
alejke ejjuhen-nebijju ve rahmetull-llahi ve berekatuhu,
es-selamu 'alejna ve 'ala 'ibadil-lahis-salihin. Eshhedu

⁶⁹ Transmeton Ebu Davudi 1/231, (shih Sahih Ibën Maxheh 1/148).

⁷⁰ Transmetojnë autorët e katër suneneve, përvèç Nesaiut, (Sahih Et-Tirmidhi 1/90 dhe Sahih Ibën Maxheh 1/148).

⁷¹ Tramsmetojnë Tirmidhiu 2/474, Ahmedî 6/30, dhe Hakimi thotë se hadithi është i vërtetë. Me këtë pajtohet edhe Dhehebiu 1/220. Shtojcën pas pikëpresjes e transmeton Dhehebiu.

⁷² Transmetojnë: Tirmidhiu 2/473 dhe Hakimi, i cili thotë se hadithi është i vërtetë. Me këtë pajtohet edhe Dhehebiu 1/219.

*en la Ilahē il-lAllahu ve eshhedu enne Muhammeden
'abduhu ve resuluhu.*

(Nderimi, lutjet dhe tē gjitha mirësitë i takojnë All-llahut. Le tē jetë paqja mbi ty o pejgamber (i Zotit), paqja le tē jetë mbi tē gjithë ne dhe mbi tē gjithë robërët e mirë tē All-llahut. Dëshmoj se nuk ka tē adhuruar tjetër përvëç All-llahut dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i Dërguar i Tiji)⁷³

23-SALAVATI MBI PEJGAMBERIN ﷺ PAS TESHEH-HUDIT

(53)

اللَّهُمَّ صَلُّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ
إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ.

*All-llahumme sal-li 'alá Muhammedin ve 'ala áli
Muhammed, kema sal-lejte 'alá Ibrahime ve 'alá áli
Ibrahim inneke Hamidun Mexhid.*

(O Zot, ki mëshirë ndaj Muhammedit dhe familjes së tij,
siç pate mëshirë ndaj Ibrahimit dhe familjes së tij, se
vërtet Ti je i Lavdëruar dhe i Madhërishëm)

اللَّهُمَّ بارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ
إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ.

*All-llahumme barik 'alá Muhammedin ve 'alá áli
Muhammed kema barekte 'ala Ibrahime ve 'alá áli
Ibrahim inneke Hamidun Mexhid.*

(O Zot, bekoje Muhammedin dhe familjen e tij, siç e
bekove Ibrahimin dhe familjen e tij, se vërtet Ti je i
Lavdëruar dhe i Madhërishëm)⁷⁴

(54)

اللَّهُمَّ صَلُّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى أَزْوَاجِهِ وَذَرِيَّتِهِ كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ.
وَبَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى أَزْوَاجِهِ وَذَرِيَّتِهِ كَمَا بَارَكْتَ عَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ.
إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ.

*All-llahumme sal-li 'alá Muhammedin ve 'alá ezvaxhihi
ve dhurrijjetihi, kema sal-lejte 'ala áli Ibrahim, ve bárík
'alá Muhammedin ve 'alá ezvaxhihi ve dhurrijjetihi,
kema bárekte 'alá áli Ibrahime inneke Hamidun Mexhid.*

(O Zot, ki mëshirë ndaj Muhammedit, bashkëshorteve të
tij dhe pasardhësve të tij, siç pate mëshirë ndaj familjes
së Ibrahimit, dhe bekoje Muhammedin, bashkëshortet e
tij dhe pasardhësit e tij, siç e bekove familjen e Ibrahimit.
Vërtet, Ti je Lavdiplotë dhe i Madhërishëm)⁷⁵

24-DUATË PAS TESHEHHUDIT TË FUNDIT PARA SELAMIT

(55)

اللَّهُمَّ إِنِّي أَغُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ، وَمِنْ عَذَابِ جَهَنَّمَ، وَمِنْ فِتْنَةِ الْحَجَّةِ
وَالْمَمَّاتِ، وَمِنْ شَرِّ فِتْنَةِ الْمُسِّيْحِ الدَّجَّالِ.

⁷⁴ Transmeton Buhariu (Fet-hul-Bari 6/408).

⁷⁵ Transmetojnë Buhaariu (Fet-hul-Bari 6/407) dhe Muslimi 1/306,
këtë version e transmeton Muslimi.

⁷³ Transmetojnë: Buhariu (Fet-hul-Bari 1/13), Muslimi 1/301.

*All-llahumme inni e'udhu bike min 'adhabil-kabr, ve
min 'adhabi xhehennem, ve min fitnetil-mahja vel-memat,
ve min fitnetil-Mesihid-dexhal.*

(O Zoti im, kérkoj mbrojtjen Tënde nga dënim i Xhehennem, si dhe kérkoj mbrojtjen Tënde nga sprova e jetës dhe e vdekjes dhe nga sprova e Dexhxhallit.)⁷⁶

(56)

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ فِتْنَةِ الْمُسِيْحِ الدَّجَّالِ،
وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ فِتْنَةِ الْمَحْيَا وَالْمَمَاتِ. اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْمَأْمَمِ
وَالْمَغْرِمِ.

*All-llahumme inni e'udhu bike min 'adhabil-kabr, ve
e'udhu bike min fitnetil-Mesihid-dexhxhal, ve e'udhu bike
min fitnetil-mahja vel-memat. All-llahumme inni e'udhu
bike minel-me`themi vel-magrem.*

(O Zoti im, kérkoj strehimin Tënd nga dënim i varr, nga fitnja e Dexhxhalit dhe nga sprova e jetës dhe e vdekjes. O Zoti im, kérkoj mbrojtjen Tënde nga mëkatet dhe nga borxhet (ndaj njerëzve)⁷⁷)

(57)

اللَّهُمَّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي ظَلَمًا كَثِيرًا وَلَا يَغْفِرُ الذُّنُوبُ إِلَّا أَنْتَ فَاغْفِرْ لِي
مَغْفِرَةً مِنْ عِنْدِكَ وَارْحَمْنِي، إِنَّكَ أَنْتَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ.

*All-llahumme inni dhalemtu nefsi dhulmen kethiren, ve la
jagfirudh-dhunube il-la Ente, fagfirli magfireten min
'indeke ver-hamni inneke Entel-Gafurur-Rahim.*

(O Zoti im, i kam bërë vetes shumë dëm, kurse nuk i fal mëkatet askush tjetër përveç Teje, andaj të lutem më fal mua me faljen Tënde dhe më mëshiro. Vërtet, Ti je Falës dhe i Mëshirshëm)⁷⁸

(58)

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي مَا قَدَّمْتُ، وَمَا أَخْرَنْتُ، وَمَا أَسْرَرْتُ، وَمَا
أَسْرَفْتُ وَمَا أَنْتَ أَعْلَمُ بِهِ مِنِّي. أَنْتَ الْمَقْدُمُ، وَأَنْتَ الْمَؤْخَرُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ.

88-DHIKRI ME TË CILIN ALLAHU TË MBRON PREJ DEXH-XHALLIT

(199)

"Kush i mëson përmendsh dhjetë ajetet e para të sures "EL-KEHF", është i mbrojtur nga dexh-xhalli".²²⁸

Të kërkuarit e mbrojtjes së All-lahut të Madhërishtëm nga sprova e dexh-xhallit, pas teshehudit të fundit në çdo namaz.²²⁹

89-DUAJA PËR ATË QË TË THOTË

إِنِّي أَحِبُّكَ فِي اللهِ

Inni uhibbuke fil-lah

²²⁶ Transmetojnë Ahmedji 5/82, dhe Nesaiu në Amelul-jevmi vel-lejleh, fq.218, nr:421, me recensimin e dr. Faruk Hamades.

²²⁷ Transmeton Tirmidhiu, nr: 2035, (Sahih El-Xhamiu, nr: 6244, dhe Sahih Et-Tirmidhi 2/200).

²²⁸ Transmeton Muslimi 1/555 dhe në transmetimin tjetër: Dhjetë ajetë e fundit të sures B-Kelj 1/556.

²²⁹ Shih Hadithet nën nr: 55, 56 nën fusnotën: 79, 80.

(200)

أَحْبَكَ الَّذِي أَحْبَبْتَنِي لَهُ.

Ehabbekel-ledhi ahbebtjeni leh

(*Të dashitet Ai pér hir tē tē Cilit më deshe*)²³⁰

90-DUAJA PËR ATË QË TË OFRON PASURI

(201)

بَارَكَ اللَّهُ لَكَ فِي أَهْلَكَ وَمَالِكَ.

BarekAll-lahu leke fi Ehlike ve malike

(*Të bekofitë All-lahu në familjen dhe pasurinë Tënde*)²³¹

91-DUAJA E ATIJ QË TË KA BORXH KUR TA KTHEN
ATË

(202)

بَارَكَ اللَّهُ لَكَ فِي أَهْلَكَ وَمَالِكَ، إِنَّمَا جَزَاءُ السَّلْفِ الْحَمْدُ وَالْأَذَاءُ.

*BarekAll-lahu leke fi Ehlike ve mālike, innema xhezáus-
selefi el hamdu vel-edái*

(*Të bekofitë All-lahu në familjen dhe pasurinë Tënde,
vërtet shpërblimi i borxhit është falënderimi dhe
kthimi*)²³²

(203)

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ أَنْ أُشْرِكَ بِكَ وَإِنِّي أَعْلَمُ وَأَسْتغْفِرُكَ لِمَا لَأَعْلَمُ.

*All-lahumme inni e 'udhu bike en ushrike bike ve ene
a 'ëlemu ve estagfiruke lima la a 'ëlemu*

(*O Zot, kërkoj mbrojtjen Tënde nga shirku tē cilin e di
dhe kërkoj faljen Tënde pér atë që unë nuk e di*)²³³.

93-DUAJA PËR ATË QË TË THOTË:

بَارَكَ اللَّهُ فِيكَ.

BarekAll-lahu fike

(*All-lahu tē bekofitë*)

(204)

وَفِيكَ بَارَكَ اللَّهُ.

Ve fike barekAll-lahu

(*Edhe ty tē bekofitë All-lahu*)²³⁴.

94-DUAJA KUNDËR

MBËSHTETJES NË OGURE

(205)

اللَّهُمَّ لَا طَيْرٌ إِلَّا طَيْرُكَ وَلَا خَيْرٌ إِلَّا خَيْرُكَ وَلَا إِلَهٌ غَيْرُكَ.

²³⁰ Transmeton Ebu Davudi 4/333, Albani e ka bërë hadithin tē mirë (hasen) në Sahih Sunen Ebi Davud 3/965.

²³¹ Transmeton Buhari me Fet-h 4/88.

²³² Transmeton Nesaiu në Amelul-jevmi vel-lejleh fq. 300 dhe Ibën Maxheh 2/809, (Sahih Ibën Maxheh 2/55).

²³³ Transmeton: Ahmedi 4/403 dhe tē tjerë, (Sahih El-Xhamiu 3/233 dhe Sahih Et-tergib ve Et-terhib tē autorit Albani 1/19).

²³⁴ Transmeton Ibën Sunnij, fq. 138, nr. 278, El-Vabil ES-Sajjib, tē Ibnul- Kajjimit fq. 304, me recensimin e Beshir Muhammed Nuajm.

*All-llahumme la tajre il-la tajruke ve la hajre il-la
hajruke, ve la ilahe gajruke.*

(O Zot, s`ka tajre²³⁵ pérveç tajres Sate, s`ka tē mirë pérveç tē mirës Sate dhe s`ka tē adhuruar tjetër pérveç Teje).²³⁶

95-DUAJA GJATË HIPJES NË MJETIN E UDHËTIMIT (206)

بِسْمِ اللَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ سُبْحَانَ الَّذِي سَخَّرَ لَنَا هَذَا وَمَا كُنَّا لَهُ مُقْرِنِينَ وَإِنَّا إِلَى رَبِّنَا لَمْ نَقْلِبُوْنَ، الْحَمْدُ لِلَّهِ، الْحَمْدُ لِلَّهِ، اللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُ أَكْبَرُ أَكْبَرُ سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي فَاغْفِرْ لِي فِإِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ.

Bismil-lah, vel-Hamdu Lil-lah [Subhanel-ledhi sehare lena hadha ve ma kunna lehu mukrinin ve inná ilá Rabbina le munkalibún], EL-Hamdulil-lah, (3 herë), All-lahu Ekber, (3 herë), Subhaneke All-llahumme inní dhalem-tu nefsí fagfir lí, fe innehu la jagfirudh-dhunube il-la Ente.

(Me e mrin e All-llahut, falënderimi i takon All-llahut, i Lartmadhërihem qoftë Ai i Cili i nënshtroi këto pér ne, sepse ne nuk do tē kishim mundësi ta bënëm këtë; ne me tē vërtetë te Zoti ynë do tē kthehem; Falënderimi i qoftë All-llahut, Falënderimi i qoftë All-llahut. Falënderimi i qoftë All-llahut, All-llahu èshtë më i Madhi, All-llahu èshtë më i Madhi; All-llahu èshtë më i Madhi, i Lartë qofsh o Zoti i m, u në i kam bërë dëm (zullum) vvetves, prandaj më fal mua, sepse askush pérveç teje nuk mund t'i falë mëkatet)²³⁷

96-DUAJA E UDHËTIMIT (207)

اللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُ أَكْبَرُ سُبْحَانَ الَّذِي سَخَّرَ لَنَا هَذَا وَمَا كُنَّا لَهُ مُقْرِنِينَ وَإِنَّا إِلَى رَبِّنَا لَمْ نَقْلِبُوْنَ، اللَّهُمَّ إِنَّا نَسْأَلُكَ فِي سَقْرِنَا هَذَا الْبُرُّ وَالْتَّقْوَىٰ، وَمِنَ الْعَمَلِ مَا تُرْضَىٰ، اللَّهُمَّ هَوْنَ عَلَيْنَا سَقْرِنَا هَذَا وَاطْهُ عَنَّا بَعْدَهُ، اللَّهُمَّ أَنْتَ الصَّاحِبُ فِي السَّقْرِ، وَالْخَلِيفَةُ فِي الْأَهْلِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ وَعْثَاءِ السَّقْرِ، وَكَبَابَةِ الْمُنْتَرِ وَسَوْءِ الْمُنْقَلَبِ فِي الْمَالِ وَالْأَهْلِ.

All-llahu ekber, All-llahu ekber, All-llahu ekber! (3 herë)

Subhanel-ledhi sehare lena hadha ve ma kunna lehu mukrinin ve inná ilá Rabbina le munkalibún. All-llahumme inná nes`elu ke seferina hadha el-birre vet-takva ve minel- 'ameli ma terdá, All-llahumme hevvin 'alejna seferena hadha vetvi 'anna bu'deh, All-llahumme entes-sahibu fis-sefer vel-halifetu fil ehl, All-llahumme inni

²³⁵ Mbështetje në ogure, në parashenja tē këqija ose tē mira.

²³⁶ Transmeteton A hmedi 2/220 d he Ibën Sunnij nr: 292, Albani e ka bërë tē vërtetë në Silsiletul-Ehadith es-Sahiha 3/54, nr: 1065, kurse sa i pérket parashiki-mit tē së mirës (për tē cilin arabët përdorin termin El-Fe `lun sh.p.) i pëlqente kjo fjalë Pejgamberit alejhis-selam dhe pér këtë e dëgjoi një fjalë tē mirë prej një personi dhe i pëlqeu dhe tha: "E morëm fjalën tēnde tē mirë (Fe `lin), nga goja jote". Transmetojnë Ebu Davudi dhe A hmedi. Albani e ka bërë tē vërtetë në librin Silsiletul-Ehadith Es-Sahiha 2/363, te Ebi Ali-Shejh në librin Ahlaku i Pejgamberit alejhis-selam fq. 270.

*e'udhu bike min va 'éthais-sefer ve keábetil-mendhar ve
sú'il-munkalebi fil-mali vel-ehl. (3 herë)*

(All-lahu eshtë më i madhi!)

*I Lartmadhérishëm q ofti A i që i nënshtroi këto për ne,
sepse ne nuk do të kishim pasur mundësi ta bënim këtë.
Ne me të vërtetë tek Zoti ynë do të kthehem. O Zoti ynë,
të lutemi që në udhëtimin tonë të na mundësosh të bëjmë
mirësi dhe të jemi të devotshëm, të bëjmë vepra me të
cilit Ti je i kënaqur. O Zoti ynë, na e lehtëso neve
udhëtimin tonë dhe na e bëj të rehatshme rrugën. O Zoti
ynë, Ti je shoqërues në udhëtim dhe mbrojtës i familjes
sonë. O Zoti im, kërkoj që të më mbrosh nga vështirësitë
e udhëtimit dhe nga kënaqësitë e tij, nga shikimet
qëllimkëqija dhe nga telashet me pasuri dhe familje).*

*Pejgamberi ﷺ, kur kthehej nga udhëtimi, i thoshte të
njëjtat fjalë, dhe shtonte:*

أَبْيُونَ تَائِبُونَ عَابِدُونَ لِرَبِّنَا حَامِدُونَ.

Ájibún táibún 'ábidún li Rabbina hámidún

*(U kthyem me pendim dhe përkushtim, duke i bërë Zotit
tonë falënderim)²³⁸*

97-DUAJA GJATË HYRJES NË NDONJË FSHATA QYTET

(208)

²³⁸ Transmeton Muslimi 2/998.

اللَّهُمَّ رَبَّ السَّمَاوَاتِ السَّبْعِ وَمَا أَظْلَلْنَ، وَرَبَّ الْأَرَضِينَ السَّبْعِ وَمَا أَفْلَلْنَ،
وَرَبَّ الشَّيَاطِينَ وَمَا أَضْلَلْنَ وَرَبَّ الرِّيَاحِ وَمَا ذَرَنَ. أَسْأَلُكَ خَيْرَ هَذِهِ
الْقَرِيَّةِ وَخَيْرَ أَهْلِهَا وَخَيْرَ مَا فِيهَا، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّهَا وَشَرِّ أَهْلِهَا، وَشَرِّ
مَا فِيهَا.

*All-lahumme Rabbes-semavatis-seb'i ve ma adhlene, ve
Rabbel-eredines-seb'i ve aklelne, Rabbesh-shejátini ve
ma adlelne, ve Rabber-rijáhi ve ma dhorejne. Es`eluke
hajre hadhihil-karjeti ve hajre ehliha, ve hajre ma fiha,
ve e'udhu bike min sherriha ve sherri ehliha, ve sherri
ma fiha.*

*(O All-lah, Zot i shtatë qiejve dhe i asaj që e mbulojnë,
Zot i shtatë tokave dhe asaj që ato mbajnë, Zot i
shejtanëve dhe i atyre që ata i kanë dërguar në humbje,
Zot i erës dhe asaj që ato shpërndajnë, të lutem të më
japësh të mirën e këtij fshati, mirësinë e banorëve të tij, të
mirën e asaj që gjendet në të dhe kërkoj që të më mbrosh
nga dëmi i këtij fshati, dëmi i banorëve të tij dhe dëmi i
asaj që gjendet në të)²³⁹*

98-DUAJA E HYRJES NË TREG

(209)

²³⁹ Transmeton Hakimi, i cili e ka bërë hadithin të vërtetë, kurse Dhehebiu e ka pëlqyer 2/100. Transmeton gjithashtu Ibën Sunnij nr.524. Ibën Haxheri, në redaktimin e librit "El-Edhkare" 5/154, e ka bërë të mirë (hasen). Ibën Bazi thotë: Këtë hadith e transmeton Nesaiu, me sened të mirë (Tuhfetul-Ahjar sq.37).

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَةٌ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ يُحْسِنُ وَيُمْسِيْنَ وَهُوَ
حَيٌّ لَا يَمُوتُ بِبَيْدِهِ الْخَيْرُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ.

*La ilah il-lAllahu vahdehu la sherike leh, lehul-Mulku
ve lehul-hamdu, juhjí ve jumitu, ve Huve hajjun la jemútu
bi jedihi el-hajru ve Huve 'alá kul-li shej'in Kadír.*

(S)ka tē adhuruar tjetér pérveç All-llahut, Një dhe tē Pashoq; Atij i takon sundimi dhe vetém Atij i takon falënderimi; Ai jep jetë dhe vdekje, ndërsa Ai është i Gjallë i Cili nuk vdes kurrë. Në Dorën e Tij është e mira (hajri) dhe mbi çdo send Ai është i plotfuqishëm)²⁴⁰

99-DUAJA KUR TË PENGOHET MJETI I UDHËTIMIT

(210)

بِسْمِ اللَّهِ

Bismil-lah

*(Me emrin e All-llahut).*²⁴¹

100-DUAJA E UDHËTARIT PËR ATË QË NUK UDHËTON

(211)

أَسْتَوْدِعُكُمُ اللَّهُ الَّذِي لَا تَضْبِعُ وَذَانِعًا.

²⁴⁰ Transmetojnë: Tirmidhiu 5/291 dhe Hakimi 1/538. Albani e ka bërë tē mirë (hasen) në librin Sahih Ibën Maxheh 2.21 dhe Sahih Et-Tirmidhi 3/152.

²⁴¹ Transmeton Ebu Davudi 4/296, Albani e ka bërë tē vërtetë në librin Sahih Ebi Davud 3/941.

EsteVDI 'ukumull-llahe el-ledhi la tedi 'u vedai 'uhu

*(Ju lë nën kujdes tē All-llahut, i Cili nuk i humb porositë e Tij).*²⁴²

101-DUAJA E ATIJ QË NUK UDHËTON PËR UDHËTARIN

(212)

أَسْتَوْدِعُ اللَّهَ دِينَكَ وَأَمَانَتَكَ، وَخَوَاتِيمَ عَمَلِكَ.

EsteVDI 'ull-llahe dineke ve emánetek, ve havátime 'amelike.

*(Në mbrojtjen e All-llahut qofshin feja jote, besa jote dhe përfundimi i punëve tuaja)*²⁴³

(213)

رَوَّنَكَ اللَّهُ التَّقْوَى، وَغَفَرَ ذَنْبَكَ وَيَسَّرَ لَكَ الْخَيْرَ حَيْثُمَا كُنْتَ.

ZevvedekAll-llahu Et-takvá, ve Gafere dhenbek, ve jessere lekel-hajre hajthu ma kunte

*(Të furnizoftë All-llahu me devotshmëri, t'i faltë mëkatet dhe t'i lehtësoftë punët e mira kudo që tē jesh).*²⁴⁴

102-TEKBIRI DHE TESBIHU GJATË UDHËTIMIT

(214)

Transmetohet nga Xhabiri radijAll-llahu anhu, i cili ka thënë: "Kur hipnim (në mjetin e udhëtimit), merrnim

²⁴² Transmetojnë Ahmedji 2/403, Ibën Maxheh 2/943 (Sahih Ibën Maxheh 2/133).

²⁴³ Transmetojnë: Ahmedji 2/7, Tirmidhiu 5/499, (Sahih Et-Tirmidhi 2/155).

²⁴⁴ Transmeton Tirmidhiu (Sahih et-Tirmidhi 3/155).

tekbir, ndërsa kur zbrisnim, e madhëronim All-llahun (d.m.th. e bënim tesbih) ”.²⁴⁵

103-DUAJA E UDHËTARIT PARA AGIMIT TË MËNGJESIT

(215)

سَمِعْ سَامِعَ بِحَمْدِ اللَّهِ وَحْسُنَ بِلَاهِ عَلَيْنَا. رَبَّنَا صَاحِبَتَا وَأَفْضَلُ عَلَيْنَا عَائِدًا
بِاللَّهِ مِنَ النَّارِ.

Semme 'a sámi 'un bi hamdil-lahi, ve husni beláhi 'alejna. Rabbená Sáhibná ve esdil 'alejna 'áidhen bil-lahi minen-nar.

(Ai që dëgjon dhe që ka dëgjuar përfalënderimin tonë ndaj All-llahut, për begatitë e Tij dhe mirësitë e Tij ndaj nesh; O Zoti ynë, na shoqëro dhe na jep dhunti duke kërkuar mbrojtjen Tënde prej zjarrit)²⁴⁶

104-DUAJA KUR TË NDALESH NË NDONJË VEND, QOFTË NË UDHËTIM A JO

(216)

أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَاتِ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ.

E'udhu bi kelimatil-lahit-tammati min sherri ma halaka. (Kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të All-llahut, nga sherri (e keqja) që ka krijuar)²⁴⁷

105-DUAJA E KTHIMIT NGA UDHËTIMI

(217)

الله أَكْبَرُ، الله أَكْبَرُ، الله أَكْبَرُ.
لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَةٌ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ
قَبِيرٌ، آيُّونَ تَائِفُونَ، عَابِدُونَ لِرَبِّنَا حَامِدُونَ، صَدَقَ اللَّهُ وَعْدَهُ، وَنَصَرَ
عِنْدَهُ وَهُنَّ الْأَخْرَابُ وَحْدَةٌ.

All-llahu Ekber, All-llahu Ekber, All-llahu Ekber:

La ilahe il-lAll-llahu vahdehu la sherike leh, lehul mulku ve lehul hamdu ve huve ala kul-li shej'in kadir ájibún tâibún 'ábidún li Rabbina hámidún. SadekAll-llahu va 'deh, ve nesare 'abdeh, ve hezemel-ahzâbe vahdeh.

(S'ka të adhuruar përveç All-llahut, Një dhe i Pashoq, Atij i takon sundimi dhe lavdërimi, Ai është i Plotfuqishëm mbi çdo send. U kthyem me pendim dhe përkushtim, duke i bërë Zotit tonë falënderim, All-llahu e

²⁴⁵ Transmeton Buhariu (*Fet-hul-Bari* 6/135).

²⁴⁶ Transmeton Muslimi 4/2086, shih Komentin e Neveviut 4/2080.

²⁴⁷ Transmeton Muslimi 4/2080. Këtë e thoshte kur kthehej nga ndonjë betejë ose kur kthehej nga Haxh-xhi.

përmbushi premtimin e Tij, e ndihmoi robin e Tij dhe i mposhti grupacionet Vetëm [pa ndihmën e askujt]²⁴⁸

106-Ç'THOTË AI QË MERR LAJME TË KËQIJA OSE TË MIRA

(218)

Pejgamberi ﷺ kur i ndodhte ndonjë e mirë, thoshte:

الْحَمْدُ لِلّٰهِ الَّذِي بِنَعْمَتِهِ تَتَمَّ الصَّلٰحَاتُ.

El-Hamdu Lil-lahil-ledhi bi ni 'emetihi tetimmus-sálihát.

(Falënderimi i qoftë All-llahut i Cili me begatinë e Tij i plotëson punët e mira) ndërsa për ndonjë lajm të keq, thoshte:

الْحَمْدُ لِلّٰهِ عَلٰى كُلِّ حَالٍ.

"El-Hamdu Lil-lahi 'alá kul-li hál"

(Falënderimi i takon All-llahut për çdo gjendje)²⁴⁹

107-VLERA E PËRSHËNDETJES (SALAVATIT) MBI PEJGAMBERIN ﷺ

(219)

Pejgamberi ﷺ ka thënë:

"Kush më dërgon mua një salavat, All-lahu i Madhërishëm ka për t'i dërguar atij dhjetë salavate."²⁵⁰

²⁴⁸ Buhariu 7/163, Muslimi 2/980.

²⁴⁹ Transmeton Ibën El-Sunnij në Amelul-jevmi vel-lejleh, dhe Hakimi, i cili e ka bërë të vërtetë 1/499. Gjithashtu Albani e ka bërë të vërtetë në librin Sahih El-Xhamiu 4/201.

²⁵⁰ Transmeton Muslimi 1/288.

(220)

Pastaj ka vazhduar:

"Mos e bëni varrin tim festë (për vizitë), por bini salavat mbi mua, se salavati juaj më arrin mua kudo që të jeni".²⁵¹

(221)

Për këtë, po ashtu, ka thënë:

"Koprrac éshtë ai i cili kur përmendem pranë tij, nuk bie salavat mbi mua".²⁵²

(222)

Pastaj ka shtuar:

"All-lahu ka melaike të cilat shëtisin nëpër tokë dhe m'i përcjellin përshtëndetjet e ummetit tim".²⁵³

(223)

dhe në fund Pejgamberi ﷺ ka thënë:

"S'më përshtëndet askush e që All-lahu të mos ma kthejë shpirtin derisa t'ia kthej përshtëndetjen".²⁵⁴

108-PËRHAPJA E SELAMIT

(224)

²⁵¹ Transmetojnë Ebu Davudi 2/218, Ahmedji 2/367. Albani e ka bërë të vërtetë në Librin Sahih Ebi Davud 2/383.

²⁵² Transmeton Tirmidhiu dhe të tjerrë (Sahih El-Xhamiu 3/25 dhe Sahih Et-Tirmidhi 3/177).

²⁵³ Transmetojnë Nesaiu dhe Hakimi 2/421. Albani e ka bërë të vërtetë në librin Sahih En-Nesai 1/274.

²⁵⁴ Transmeton: Ebu Davudi nr.2041, Albani e ka bërë të mirë (hasen) në librin Sahih Ebi Davud.

Transmetohet se Pejgamberi ﷺ ka thënë:

"S`keni për të hyrë në Xhennet, derisa të besoni dhe s`keni besuar derisa të duheni. A t`ju udhëzoj në një gjë të cilën nëse e veproni keni për t`u dashur. Përhapeni selamin ndërmjet jush".²⁵⁵

(225)

"Kush i tubon tri cilësi, e ka tubuar (përfshirë) besimin: Të qenët joegoist, dhënen e selamit njerëzve dhe dhënen e sadakasë në skamje".²⁵⁶

(226)

Transmetohet nga Abdull-llah ibën Omeri (All-llahu qoftë i kënaqur më të) se një njeri e ka pyetur Pejgamberin ﷺ :

"Cili është Islami më i mirë?"

Pejgamberi ﷺ i tha: "T'i ushqesh nevojtarët, t'i japësh selam atij të cilin e njeh dhe atij të cilin nuk e njeh".²⁵⁷

109-SI DUHET KTHYER SELAMIN JOBESIMTARËVE,
NËSE JAPIN SELAM

(227)

Transmetohet se Pejgamberi ﷺ ka thënë:

"Nëse ju japid selam Ehli Kitabët, 258 thuajuni:

وَعَلَيْكُمْ

²⁵⁵ Transmeton Muslimi 1/74 dhe të tjerrë.

²⁵⁶ Transmeton Buhari me Fet-h 1/82, nga Ammari radij All-llahu anhu, mevkuf.

²⁵⁷ Transmetojnë: Buhari me Fet-h 1/55, Muslimi 1/65.

²⁵⁸ Me fjalën Ehli Kitab nënkuptojmë: të krishterët dhe çifutët.

"Ve 'alejkum"

(Edhe mbi ju)²⁵⁹

110-Ç`DUHET THËNË KUR KËNDON GJELI DHE
PËLLET GOMARI

(228)

Transmetohet se Pejgamberi ﷺ ka thënë:

"Kur ta dëgjoni gjelin duke kënduar, luteni All-llahun që t`ju jap nga të mirat e Tij, sepse ai (gjeli) e ka parë melekun, ndërsa kur ta dëgjoni palljen e gomarit, kërkoni mbrojtjen e All-llahut nga shejtani, sepse ai e ka parë shejtanin".²⁶⁰

111-Ç`DUHET THËNË KUR TË LEHIN QENTË NATËN

(229)

Transmetohet se Pejgamberi ﷺ ka thënë:

"Kur t`i dëgjoni të lehurat e qenve dhe palljet e gomarëve në mbrëmje, kërkoni mbrojtjen e All-llahut prej tyre, sepse ata shohin atë që ju nuk e shihni".²⁶¹

112-DUAJA PËR ATË TË CILIN E KE OFENDUAR

(230)

Pejgamberi ﷺ ka thënë:

اللَّهُمَّ فَأَئِمَا مُؤْمِنٌ سَبَبْتُهُ فَاجْعَلْ ذَلِكَ لَهُ قُرْبَةً إِلَيْكَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ.

²⁵⁹ Transmetojnë: Buhari me Fet-h 11/42, Muslimi 4/1795.

²⁶⁰ Transmetojnë: Buhari me Fet-h 6/350, Muslimi 4/2092.

²⁶¹ Transmetojnë: Ebu davudi 4/327 dhe Ahmed 3/306. Albani e ka bërë të vërtetë në librin Sahih Ebi Davud 3/961.

*All-llahumme fe ejjuma mu'minin sebebtuhu fexh 'al
dhaliqe lehu kurbeten ilejke jevmel kijameti*
*"O Zot, cilindo besimtar që e kam ofenduar, bëja atij
këtë afrim te Ti Ditën e Gjykit".²⁶²*

113-Ç'THOTË MUSLIMANI KUR TA LAVDËROJË VËLLANË E VET (NË FE)

(231)

Pejgamberi ﷺ ka thënë:

"Nëse ndonjëri prej jush e lavdëron shokun e tij, le të thotë: "E konsideroj filanin të këtillë, e All-lahu e di më së miri për të dhe nuk e lavdëroj askënd para All-lahut, e konsideroj (nëse di për të) kështu dhe kështu".²⁶³

114-Ç'DUHET TË THOTË MUSLIMANI KUR TA LAVDËROJË DIKUSH

(232)

اللَّهُمَّ لَا تُؤَاخِذنِي بِمَا يَعْلَمُونَ وَاغْفِرْ لِي مَا لَا يَعْلَمُونَ وَاجْعَلْنِي خَيْرًا مِّمَّا يَظْنُونَ

*All-llahumme la tuáhidhní bima jekú-lún, vagfir lí ma la
ja 'élemun [vexh- 'alní hajren mimma jedhunnún]*

(O Zot, mos më dëno për atë që thonë, m'i fal ato që nuk i dinë, [dhe më bëj më të mirë sesa mendojnë])²⁶⁴

²⁶² Transmeton Buhariu (Fet-hul-Bari 11/171, Muslimi 4/2007).

²⁶³ Transmeton Muslimi 4/2296.

²⁶⁴ Transmeton: Buhariu në librin El-Edebul-Mufred, nr.761, senedin e këtij hadithi e ka bërë të vërtetë Albani në librin e tij Sahih El-Edebul-Mufred nr.585, ndërsa ajo që është ndërmjet klapave e

115-TELBIA PËR HAXHXH DHE UMRE

(233)

لَيَبِيكَ اللَّهُمَّ لَيَبِيكَ، لَيَبِيكَ لَا شَرِيكَ لَكَ لَيَبِيكَ، إِنَّ الْحَمْدَ وَالنُّعْمَةَ لَكَ وَالْمَلْكَ، لَا شَرِيكَ لَكَ.

*Lebbejk All-llahumme Lebbejk, Leb-bejk La sherike Leke
Lebbejk, innel-Hamde ven-ni 'ëmete leke vel-Mulk Lá
sherike Lek*

(Të përgjigjem o Zot, të përgjigjem, Ti je i Pashoq, vetëm Ty të përgjigjem, falënderimi të takon vetëm Ty. Të gjitha begatitë dhe e tërë pasuria janë Tuajat, Ti je i parival (i Pashoq).²⁶⁵

116-TEKBIRI ME RASTIN E AFRIMIT TË HAXHERUL- ESVEDIT

(234)

*Pejgamberi ﷺ ka bërë tavaf rrëth Qabes, i hipur mbi
deve, dhe sa herë që vinte te Haxherul-esvedi ia drejtonte
shkopin e vet dorë dhe merrete tekbir.²⁶⁶*

117-DUAJA NDËRMJET RUKNUL-JEMANIT DHE HAXHERUL-ESVEDIT

(235)

(رَبَّنَا أَتَنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً وَتَنَا عَذَابَ النَّارِ)

transmeton Bejhekiu në librin e tij Shuabul-Iman 4/228, me rrugë tjetër të transmetimit.

²⁶⁵ Transmeton Buhariu (Fet-hul-Bari 3/408, Muslimi 2/841).

²⁶⁶ Transmeton Buhariu (Fet-hul-Bari 3/476 dhe 3/472).

Rabbena átiná fid-dunja haseneten ve fil-áhireti
haseneten vekina 'adháben-nar.

(O Zoti ynë, na jep tē mira nē këtë botë dhe nē Ahiret dhe na ruaj prej dënimit tē zjarrit [Xhehennemit]).²⁶⁷

118-DUAJA E QËNDRIMIT MBI SAFFA DHE MERVE

(236)

Kur i është afruar Pejgamberi ﷺ Saffas, e ka lexuar ajetin:

إِنَّ الصَّفَا وَالْمَرْوَةَ مِنْ شَعَابِ اللَّهِ...)

أَذْنًا بِمَا بَدَأَ اللَّهُ بِهِ.

"Imes-safa vel-mervete min she'airil-lahi..." ebdeu bima
bedeAll-llahu bili

dhe ka thënë: "Po filloj me atë që ka filluar All-llahu".

Pastaj ka filluar nga Saffaja, është ngjitur mbi tē derisa e ka parë Qaben, është drejtuar nga kibla, e ka madhëruar njëjësinë e All-llahut, ka marrë tekbir dhe ka thënë:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ أَنْجَزَ وَعْدَهُ، وَتَصَرَّ عَبْدَهُ وَهُرَمَ الْأَحْزَابَ وَحْدَهُ.

La ilah il-lAll-llahu vahdehu la sherike leh, lehul-Mulku
ve lehul-Hamdu ve Huve 'alá kul-li shej'in Kadir, La
ilahe il-lAll-llahu vahdeh, enxheze va'deh, ve nesare
'abdeh, ve hezemel-ahzabu vahdeh.

²⁶⁷ Transmetojnë: Ebu Davudi 2/179, Ahmed 3/411, d he Bagaviu nē librin Sherhus-Sunneh 7/128. Albani e ka bërë tē mirë (hasen) nē librin Sahih Ebi Davud 1/354, ndërsa ajeti është nē suren El-Bekare 201.

(S'ka tē adhuruar përvêç A ll-llahut Një dhe tē Pashoq,
Atij i takon sundimi dhe lavdërimi, Ai është i Plotfuqishëm mbi çdo send; e përbushit premtimin e Tij,
e ndihmoi robin e Tij dhe vetë i mposhti grupacionet /pa
ndihmën e askuj).²⁶⁸

119-DUAJA NË DITËN E AREFATIT

(237)

Transmetohet se Pejgamberi ﷺ ka thënë:

"Fjala më e mirë tē cilën e kam thënë unë dhe Pejgamberët para meje, është:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ.

La ilah il-lAll-llahu vahdehu la sherike leh, lehul-Mulku
ve lehul-Hamdu ve Huve 'alá kul-li shej'in Kadir

(S'ka tē adhuruar përvêç A ll-llahut Një dhe tē Pashoq,
Atij i takon sundimi dhe lavdërimi, Ai është i Plotfuqishëm mbi çdo send).²⁶⁹

120-PËRKUJTIMI I ALL-LLAHUT TE MESH'ARIL-HARAMI

Pejgamberi ﷺ i hipë deves derisa arriti te Mesh'aril-harami, iu drejtua kibles (bëri dua, mori tekbiro, lartësoi madhërinë dhe njëjësinë e All-llahut). Kështu vazhdoi përderisa nuk u bë qielli shumë i kuqëremtë dhe u

²⁶⁸ Transmeton Muslimi 2/888.

²⁶⁹ Transmeton Tirmidhiu. Albani e ka bërë tē mirë (hasen) (Sahih Et-tirmidhi 3/184 dhe Silsiletul-Ehadith Es-sahiha 4/6).

*largua para se tē perëndojoë dielli.*²⁷⁰

**121-MARRJA E TEKBIREVE ME RASTIN E GJUAJTJES
SË GURËVE NË XHEMERAT²⁷¹**

(239)

*Sa herë që Pejgamberi ﷺ e gjuante një gur (në Mina) në cilindo nga tri xhemeratet (gjuajtjet), ekte pak, ndalej dhe me duar tē ngritura bënte dua i kthyer nga Kibla. Këtë e bënte gjatë gjuajtjes së parë dhe tē dytë, ndërsa kur bënte gjuajtjen e tretë, pas çdo guri tē hedhur merrte tekbir dhe largohej duke mos u ndalur fare tek ai.*²⁷²

**122-DUAJA ME RASTIN E DËGJIMIT TË NDONJË
LAJMI TË ÇUDITSHËM, TË GËZUESHËM**

(240)

سُبْحَانَ اللَّهِ!

SubhanAll-llah

*(I Lartë qoftë All-lahu)*²⁷³

(241)

اللَّهُ أَكْبَرُ!

All-llahu Ekber

*(All-llahu është më i madhi)*²⁷⁴

²⁷⁰ Transmeton Muslimi 2/891.

²⁷¹ Hedhja e gurëve në tri vende në Mina gjatë Haxhxhit.

²⁷² Transmeton Buhariu (Fet-hul-Bari 3/581, 3/583, 3/584). Gjithashu transmeton edhe Muslimi.

²⁷³ Transmeton Buhariu (Fet-hul-Bari 1/210, 390, 414 dhe Muslimi 4/1857).

**123-SI DUHET TË VEPROJË AI TË CILIT I NDODH DIÇ
QË E GËZON**

(242)

*Pejgamberit ﷺ kur i ndodhte ndonjë gjë që e gjëzonte, përulej në sexhde në shenjë falënderimi All-llahut tē Madhërishëm.*²⁷⁵

**124-Ç' THOTË AI QË NDIEN DHIMBJE NË TRUPIN E
VET**

(243)

Vëre dorën në vendin që tē dhembë, dhe thuaj:

بِسْمِ اللَّهِ أَعُوذُ بِاللَّهِ وَقُرْتَبَةِ مِنْ شَرِّ مَا أَجِدُ وَأَحَذِرُ.

Bismil-lah. E'udhu bil-lahi ve kudretihî min sherri ma exhidu ve uhâdhiru. (3 herë)

*(Në emër të All-llahut. Kërkoj mbrojtjen e All-llahut me fuqinë e Tij nga e keqja e kësaj që ndiej dhe frikohem)*²⁷⁶

**125-DUAJA E ATIJ QË FRIKOHET SE MOS PO E MERR
DIKË MËSYSH**

(244)

*Nëse ndokush nga ju sheh diç që i pëlqen tek vëllai i tij, në veten e tij a në pasurinë e tij, le tē lutet që All-llahu t'ia bekojë këtë gjë, sepse syri është hak (i vërtetë).*²⁷⁷

²⁷⁴ Transmetojnë: Buhariu (Fet-hul-Bari 8/441) (Sahih Et-Tirmidhi 3/103 dhe 2/235, dhe shih Musnedin e Imam Ahmedit 5/128).

²⁷⁵ Transmetojnë autorët e katër Suneneve, përveç Nesaiut (Sahih Ibën Maxheh 1/233 dhe Irvaul-Galil 2/226).

²⁷⁶ Transmeton Muslimi 4/1728.

²⁷⁷ Transmetojnë Ahamedit në Musnedin e tij 4/447, Ibën Maxheh dhe

126-Ç'DUHET THËNË NË RASTE TË FRIKËS

(245)

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ

La Ilâhe il-lâllah

(S'ka të adhuruar tjetër përveç All-llahut)²⁷⁸

127-Ç'DUHET THËNË GJATË THERJES SË
KAFSHËVE A TË KURBANIT

(246)

بِسْمِ اللَّهِ، وَاللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُمَّ مِنْكَ وَلَكَ اللَّهُمَّ تَقْبَلُ مِنِّي.

Bismil-lah, vAll-llahu Ekber, [All-llahumme minke ve leke] All-llahumme tekabbel minni.

(Me emrin e All-llahut, All-llahu është më i madhi [O Zot kjo është nga Ti dhe për ty], O Zoti im, pranoje këtë nga unë.)²⁷⁹

128-ÇKA THUHET PËR LARGIMIN E KURTHAVE TË
SHEJTANËVE

(247)

Maliku. Albani e ka bërë të vërtetë në librin *Sahih El-Xhamiu* 1/212, (shih recensimin e librit *Zadul-Me'ad* të Shuaib dhe *Abdul-Kadër Arnautit* 4/170).

²⁷⁸ Transmetojnë *Buhariu* (*Fet-hul-Bari* 6/181), *Muslimi* 4/2208.

²⁷⁹ Transmetojnë *Muslimi* 3/1557 dhe *Bejhekiu* 9/287, pjesa e hadithit ndërmjet kllapave gjendet te *Bejhekiu* 9/287. Fjalinë e fundit e kam cekur në bazë të kuptimit nga transmetimi i Muslimit.

أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَّاتِ الَّتِي لَا يُجَاوِزُهُنَّ بِرٌّ وَلَا فَاجِرٌ مِنْ شَرٍّ مَا خَلَقَ، وَبَرًا وَدَرًا، وَمِنْ شَرٍّ مَا يَنْزَلُ مِنَ السَّمَاءِ وَمِنْ شَرٍّ مَا يَعْرُجُ فِيهَا، وَمِنْ شَرٍّ مَا نَرَا فِي الْأَرْضِ وَمِنْ شَرٍّ مَا يَخْرُجُ مِنْهَا، وَمِنْ شَرٍّ مَا فِي اللَّيلِ وَالنَّهَارِ، وَمِنْ شَرٍّ كُلِّ طَارِقٍ إِلَّا طَارِقٌ بُغْيَتِ يَارَحْمَنَ.

E'udhu bi kelimatil-lahi Et-támmáti el-leti la juxhávizuhunne berrun ve la faxhirun min sherri ma halaka, ve bere'e ve dher'e, ve min sherri ma jenzilu mines-semái, ve min sherri ma ja'éruxhu fiha, ve min sherri ma dhere'e fil-erdi, ve min sherri ma jahru xhu minha, ve min sherri fitenil-lejli ven-nehár, ve min sherri kul-li tárikin il-la tárikan, jatruku bi hajrin, já Rahmánu.

*(Kérkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të All-llahut, të cilat nuk mund t'i tejkalojë asnjë bamirës e as i prishur, nga dëmi i asaj që ka krijuar, nga dëmi i asaj që zurret nga q ielli, nga dëmi i asaj që ngjitet në të, nga dëmi i asaj që është mbi tokë dhe i asaj që del nga ajo, nga dëmi i sprovave të natës dhe të ditës dhe nga dëmi i çdo udhëtarit të natës, përveç atij që vjen me të mirë, o i Gjithëmëshirshëm).*²⁸⁰

129-TË KËRKUARIT FALJE DHE PENDIMI

(248)

Ebu Hurejra radijAll-llahu anhu thotë: "E kam dëgjuar Pejgamberin ﷺ duke thënë: "Pasha All-llahun, unë

²⁸⁰ Transmeton Ahmed 3/419, me sened të vërtetë. Gjithashtu transmeton edhe Ibën *El-Sunnij*, nr.637. Abdulkadër Arnauti e ka vërtetuar senedin e tij në vlerësimin e tij të librit të *Tahaviut*, fq.133 dhe (*Mexhmea EZ-Zeavid* 1/127).

kërkoj falje prej All-lahut dhe pendohem tek Ai më tepër se njëqind herë në ditë".²⁸¹

(250)

dhe ka thënë ﴿:

"O ju njerëz, pendohuni tek All-lahu, sepse unë pendohem njëqind herë në ditë".²⁸²

(251)

dhe ka thënë ﴿: "Kush thotë:

أَسْتَغْفِرُ اللَّهَ الْعَظِيمَ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَقُّ الْقَيُومُ وَاتُّوْبُ إِلَيْهِ.

Estagfirullahel- 'Adhim el-ledhi la ilahe il-la Huve, El-Hajjul-Kajjumu ve etubu ilejhi

(Kërkoj faljen e All-lahut të Madhërishtëm, përvëç të Cilit nuk ka të adhuruar tjetër, që është i Gjallë përgjithmonë dhe Mbikëqyrës i Përherëshëm dhe tek Ai pendohem), All-lahu do t'ia falë atij edhe në qoftë se ka ikur nga beteja".²⁸³

Dhe ka thënë ﴿: "All-lahu më së tepërm i afrohet robit të vet në pjesën e fundit të natës, nëse ke mundësi të jesh prej atyre që e përmendin All-lahun në atë moment, bëhu!".²⁸⁴

²⁸¹ Transmeton Buhariu (Fet-hul-Bari 11/101).

²⁸² Transmeton Muslimi 4/2076.

²⁸³ Transmetojnë: Ebu Davud 2/85, Tirmidhi 5/569 dhe Hakimi, i cili e ka bërë të vërtetë, kurse Dhehebiu e ka pëlqyer 1/511. Po ashtu Albani e ka bërë të vërtetë (Sahih Et-Tirmidhi 3/183 dhe Xhamiu El-Usul li Ehadith Er-Resul ﴿ 4/389, 390 me recensimin e Arnautit).

²⁸⁴ Transmetojnë: Tirmidhiu, Nesaiu 1/279 dhe Hakimi, (Sahih Et-Tirmidhi 3/183 dhe Xhamiu El-Usul, me recensimin e Arnautit 4/144).

Dhe ka thënë ﴿:

"Robi është më afér Zotit të Tij kur është në sexhde, prandaj shpeshton lutjet (në sexhde)!".²⁸⁵

Dhe ka thënë ﴿:

Me të vërtetë, disa herë zemrën time e kaplon gafleti (pakujdesia), andaj kërkoj falje prej All-lahut njëqind herë në ditë.²⁸⁶

130-VLERA E TESBIHUT,²⁸⁷ TAHMIDIT,²⁸⁸ TEHLILIT²⁸⁹
DHE E TEKBIRIT²⁹⁰

(254)

Ka thënë Pejgamberi ﴿:

Kush thotë:

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ.

SubhanAll-lahi ve bihamdihi

(I Lartë qoftë All-lahu dhe Atij i takon falënderimi), njëqind herë në ditë, i fshihen mëkatet, edhe nëse ato janë sa shkuma e detit".²⁹¹

(255)

Dhe ka thënë ﴿: Kush thotë:

²⁸⁵ Transmeton Muslimi 1/350.

²⁸⁶ Transmeton: Muslimi 4/2075 (Shih Xhamiu El-usul 4/386).

²⁸⁷ Të thuhet: SubhanAll-lah [I Lartë qofsi All-lahu].

²⁸⁸ Të thuhet: El-Hamdu Lil-lah [Falënderimi i takon All-lahut].

²⁸⁹ Të thuhet: La Ilâhe il-lâllâh [S'ka të adhuruar përvëç All-lahut].

²⁹⁰ Të thuhet: All-lahu Ekber [All-lahu është më i Madhi].

²⁹¹ Transmetojnë Buhariu 7/168 dhe Muslimi 4/2071.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَةٌ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَوِيرٌ.

La Ilahé il-lAllahu vahdehu la sherike Leh, Lehul mulku ve Lehul hamdu ve Huve 'alá kul-li shej'in kadir
(10 herë)

(S'ka tē adhuruar pérveç All-lahut, Një dhe i Pashoq, Atij i takon sundimi dhe lavdërimi, Ai eshtë i Plotfuqishëm mbi çdo send), ka shpërblimin sikur t'i ketë liruar katër persona nga bijtë e Ismailit".²⁹²

(256)

Ka thënë Pejgamberi ﷺ: "Dy fjalë janë tē lehta pér gjuhën, tē rënda në peshojë, e tē dashura te i Gjithëmëshirshmi:

(257)

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ وَسُبْحَانَ اللَّهِ الْعَظِيمِ.

SubhanAll-llahi ve bihamdihi, SubhanAll-llahil-Adhim.

(I Lartë goftë All-lahu, vetëm Atij i takon Falënderimi, i Lartë goftë All-lahu i Madhërishtëm)²⁹³

(258)

Dhe ka thënë Pejgamberi ﷺ: "Të them:

سُبْحَانَ اللَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَاللَّهُ أَكْبَرُ.

²⁹² Transmetojnë Buhariu 7/167 dhe Muslimi 4/2071.

²⁹³ Transmetojnë Buhariu 7/168 dhe Muslimi 4/2072.

SubhanAll-llahi, vel-Hamdu Lil-lahi, vela ilahé il-lAllahu, vAll-llahu Ekber", eshtë më e dashur pér mua sesa e tërë ajo që e rrezon dielli".²⁹⁴

(259)

Gjithashtu, Pejgamberi ﷺ ka thënë: "A s'doni tē fitoni çdo ditë nga njëmijë sevape? Një nga tē pranishmit pyeti: Si t'i fitojmë njëmijë sevape? Ai tha: Thuaj njëqind herë SubhanAll-llah, e shkruhen njëmijë tē mira, ose shlyhen një mijë mëkate".²⁹⁵

(260)

سُبْحَانَ اللَّهِ الْعَظِيمِ وَبِحَمْدِهِ.

"Kush thotë: "SubhanAll-llahil- 'Adhim ve bihamdihi," "i mbillet një pemë (hurme) në Xhennet".²⁹⁶

(261)

Po ashtu, Pejgamberi ﷺ ka thënë: "O Abdull-llah i bën Kajs, a dëshiron tē tē udhëzoj tek një thesar prej thesarëve tē Xhennetit? Unë i thashë: "Po, o i Dërguari i All-lahut". Ai më tha: "Thuaj:

لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللهِ.

La Havle ve la kuvvete il-la bil-lah

(S'ka ndryshim e as forcë, pos me ndihmën e All-lahut).²⁹⁷

²⁹⁴ Transmeton Muslimi 4/2072.

²⁹⁵ Transmeton Muslimi 4/2073.

²⁹⁶ Transmetojnë: Tirmidhiu 5/511, Hakimi 1/501 e ka bërë tē vërtetë, kurse Dhehebiu e ka pëlgjer. (Sahih El-Xhamiu 5/531 dhe Sahih El-Tirmidhi 3/160).

(262)

Pejgamberi ﷺ ka thënë edhe këtë: "Fjalët më të dashura tek All-lahu janë katër:

سُبْحَانَ اللَّهِ، وَلَا حَمْدَ اللَّهِ، وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ.

*SubhanAll-lah, velhamdulil-lah, ve Lailahe il-la All-lah, vAll-lahu Ekber. S'të bëhet dëm me cilëndo prej tyre të fillosh.*²⁹⁸

(263)

Ka ardhur një beduin te Pejgamberi ﷺ d'he i ka thënë: "Ma mëso një fjalë të cilën do ta them". Pejgamberi [sal-lall-lahu alejhi ve sel-em] i tha: Thuaj:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَةٌ لَا شَرِيكَ لَهُ، إِنَّ اللَّهَ أَكْبَرُ كَبِيرًا وَالْحَمْدُ لِلَّهِ كَثِيرًا، سُبْحَانَ اللَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ، لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ الْعَزِيزِ الْحَكِيمِ.

La ilahe il-All-lahu vahdehu la sherike lehu, All-lahu Ekberu kebiren, ve-lhamdu lil-lahi kethiren, SubhanAll-lahi Rabbil-'Alemiñ, La Havle ve La Kuvvete il-la bil-lahil-'Azizil-Hakim.

(S'ka të adhruuar tjetër përveç All-lahut, Një dhe i Pashoq, All-lahu është më i Madhi, Falënderimi i shumtë i takon All-lahut, i Lartë qoftë All-lahu, Zoti i botërave. S'ka ndryshim e as forcë përveç me ndihmën e All-lahut). Beduini tha: "Këto janë për Zotin tim, e çka për mua?" Tha Pejgamberi ﷺ: "Thuaj:

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي، وَارْحَمْنِي، وَاهْدِنِي، وَارْزُقْنِي

²⁹⁷ Transmetojnë: Buhari me Fet-h 11/213 dhe Muslimi 4/2076.

²⁹⁸ Transmeton Muslimi 3/1685.

All-llahummag-fir lí, ver-hamni, veh-dini, ver-zukni.

*(O Zoti im, më fal mua, më mëshiro, më udhëzo dhe më furnizo)*²⁹⁹

(264)

Kur ndonjë njeri e pranonte fenë Islame, Pejgamberi ﷺ ia mësonte namazin, pastaj e urdhëronte që të lutet me këto fjalë:

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي، وَارْحَمْنِي، وَاهْدِنِي، وَارْزُقْنِي

All-llahummag-fir lí, ver-hamni, veh-dini, ve 'áfini, ver-zukni

*(O Zoti im, më fal mua, më mëshiro, më udhëzo, më jep shëndet dhe më furnizo).*³⁰⁰

(265)

*Duaja më e vlefshme është: Elhamdulil-lah, kurse dhikri (përkujtimi i All-lahut) më i mirë është: La ilahe il-All-lah.*³⁰¹

(266)

Gjërat e mira të cilat mbesin të pavdekshme janë fjalët:

²⁹⁹ Transmeton Muslimi 4/2072 dhe ka shtuar Ebu Davudi: "Pasi e ka kthyer shpînën beduini, Pejgamberi ﷺ ka thënë: I ka mbushur të dy duart me mëresi". 1/220.

³⁰⁰ Transmeton Muslimi 4/2073 dhe në një transmetim tjetër të Muslimit: "Sepse me të vërtetë këto t'i tubojnë këtë botë dhe Ahiretin".

³⁰¹ Transmetojnë: Tirmidhiu 5/462, Ibën Maxheh 2/1249 dhe Hakimi 1/503 i cili ky e ka bërë të vërtetë, kurse Dhehebiu e ka pëlqyer (Sahih El-Xhamiu 1/362).

سُبْحَانَ اللَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ، وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا
بِاللَّهِ.

SubhanAll-llah, velhamdulil-lah, ve La Ilahe il-la All-llah, vAll-lahu Ekber, ve La havle ve la kuvvete il-la bil-lah

(I Lartë qoftë All-llahu, Falënderimi i takon All-llahut. S'ka të adhuruar përveç All-llahut, All-llahu është më i Madhi dhe s'ka ndryshim e as forcë përveç me ndihmën e All-llahut)³⁰²

131-SI BËNTE TESBIH PEJGAMBERI ﷺ

(267)

Transmetohet nga Abdull-llah ibën Omeri radijAll-llahu anhu, i cili thotë: "E kam parë Pejgamberin ﷺ duke bërë tesbih me dorën e djathtë".³⁰³

132-DISA PUNË TË MIRA DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

(268)

Kur të arrijë mbrëmja, ndaloni fëmijët tuaj, sepse shejtanët shpërndahen në atë kohë, ndërsa kur të kalojë

një pjesë e natës lëshoni ata, mbyllni dyert dhe përmendeni All-llahun [thuani bismil-lah], sepse shejtani nuk e hap derën e mbyllur; lidhni vorbat dhe përmendeni emrin e All-llahut, mbuloni enët dhe përmendeni emrin e All-llahut, e mund të vëndoni mbi të diç për së gjeri (p.sh. ndonjë thupër sh.p.) dhe fikni llampat tuaja (d.m.th. fikeni dritën).³⁰⁴

**VE SAL-LALL-LLAHU VE SEL-LEME VE BAREKE ALA
NEBIJ-JINA MUHAMMEDIN VE ALA ALIHI VE AS-HABIHI EXHME'IN**

**MËSHIRA, SHPËTIMI DHE BEKIMI I ALL-LLAHUT
QOFSHIN MBI TË DËRGUARIN TONË,
MUHAMMEDIN ﷺ, FAMILJEN E TIJ DHE TË GJITHË
SHOKËT E TIJ !**

والحمد لله رب العالمين

³⁰² Transmeton Ahmed i nën nr.513. Sipas renditjes së Ahmed Shakirit edhe isnadi i këtij hadithi është i vërtetë (Mexhmea Ez-Zevid 1/297), Ibën Haxheri në Bulug El-Meram thotë se e transmeton Nesaiu me transmetimin e Ebi Seidit. Hadithin e kanë bërë të vërtetë edhe Ibën Hibbani dhe Hakimi.

³⁰³ Transmetojnë Ebu Davudi 2/81, Tirmidhiu 5/521, (Sahih El-Xhamiu 4/271 nr.4865).

³⁰⁴ Transmetojnë Buhariu (Fet-hul-Bari 10/88) dhe Muslimi 3/1595.

Përbajtja:
(Duhet përbajtje e re)

<i>Vlera e dhikrit</i>	5
1- C'duhet thënë kur të zgjohemi nga gjumi.....	8
2- Duaja kur të veshim ndonjë rrrobë.....	11
3-Duaja kur të veshim ndonjë rrrobë të re.....	12
4-Duaja për atë i cili vesh rrobe të reja	12
5- C'duhet thënë kur e heqim rrobën	13
6- Duaja para hyrjes në nevojtore	13
7- Duaja pas daljes nga nevojtorja	14
8- Dhikri para abdesit.....	14
9- Dhikri pas përfundimit të abdesit.....	14
10- Dhikri gjatë daljes nga shtëpia	15
11- Dhikri gjatë hyrjes në shtëpi	16
12- Duaja gjatë shkuarjes në xhami.....	17
13- Duaja me rastin e hyrjes në xhami.....	18
14-Duaja me rastin e daljes nga xhamia.....	19
15- Lutjet e ezanit.....	19
16- Duaja në fillim të namazit.....	21
17- Duatë në ruku	26
18-Duatë me rastin e ngritjes nga rukuja.....	28
19-Duatë në sexhde	29
20-Duatë në uljen ndërmjet dy sexhdeve.....	31
21-Duatë e sexhdes me rastin e leximit të kur'anit.....	32
22-Tesheh-hudi.....	33
23-Salavati mbi pejgamberin ♡ pas tesheh-hudit.....	34
24-Duatë pas teshehhudit të fundit para selamit.....	35
25-Dhikri pas përfundimit të farzit të çdo namazi	41
26-Duaja e istihare namazit	47
27-Dhikri i mëngjesit dhe mbrëmjes.....	49
28-Dhikri para fjetjes.....	62
29-Duaja me rastin e rrotullimit natën	70
30-Duaja me rastin e frikës në gjumë.....	70
31-C'duhet bërë ai i cili sheh èndërr	71
32-Duaja e kunutit	71
33-Dhikri pas selamit në namazin e vitrit	73
34-Luijet në raste të brengosjes dhe pikëllimit.....	74

35-Duaja me rastin e vështirësive	75
36-Duaja me rastin e takimit me armikun dhe njerëzit në pozitë	77
37-Duaja për atë i cili i frikohet dëmit të sultanit	78
38-Duaja kundër armikut	80
39-C'duhet thënë ata që i frikësohen një populli	80
40-C'duhet vepruar ai të cilin e ka kapluar dyshimi në besim	80
41-Lutja e atij që është i ngarkuar me borpjek.....	81
42-Duaja kundër vesveseve në namaz dhe gjatë leximit të kur'anit	82
43-Duaja e atij që i vështirësoset ndonjë çështje	82
44- C'duhet thënë dhe vepruar ai cili bën ndonjë mëkat	83
45-Duaja përl largimin e djallit dhe dyshimeve të tij	83
46-Duaja kur të ndodhë diçka e papëlqyer	84
47-Mbi përgëzimin e fëmiut	84
48-Me çka duhet kërkuar mbrojtje përfëmijët	85
49-Lutja për të sëmurin kur ta vizitojmë	86
50-Mbi vlerën e vizitës së të sëmurit	86
51-Duaja e të sëmurit në prag të vdekjes	87
52-Të përkujtarit e shehadetit atij që është në prag të vdekjes	88
53-Duaja me rastin e fatkeqësisë	88
54-Duaja me rastin e vdekjes së ndonjë personi	89
55-Duaja për të vdekurin me rastin e faljes së namazit të xhenazes	89
56-Duaja e xhenazës përfëmijë	92
57-Duaja me rastin e ngushëllimit	94
58-Duaja me rastin e lëshimit të të vdekurit në varr	94
59-Duaja pas varrosjes së të vdekurit	95
60-Duaja me rastin e vizitës së varrezave	95
61-Duaja kur srynë era	96
62-Duaja kur të murmuron	97
63-Duatë e shiut	97
64-Duaja kur të bie shiu	98
65-Duaja pasi të bie shiu	98
66-Duaja kundër vërshimës	99
67-Duaja me rastin e dukjes së hënës së re	99
68-Duaja e agjieruesit kur të bëjë iftar	100
69-Duaja para ushqimit	100
70-Duaja pas ushqimit	101
71-Duaja e mysafirit për pronarin e ushqimit	102
72-Duaja për atë i cili jep për të pirë ujë apo dëshiron këtë	103

73-Duaja kur tē bëjë iftar te ndonjë familje	103
74-Duaja e agjéruesit kur prezenton në ushqim dhe nuk ha	103
75-Ç`duhet tē thojë agjéruesi kur ta ofendojë ndokush	104
76-Duaja kur shohim pemën e parë tē posapjekur	104
77-Duaja e atij i cili teshtinë	104
78-Ç`duhet thënë pabesimtarëve kur tē teshtijnë	105
79-Duaja për tē martuarit	105
80-Duaja me rastin e martaçës dhe blerjes së kafshës	106
81-Duaja para se t'i afrohemë bashkëshortes	106
82-Duaja me rastin e hidhërimit	107
83-Duaja kur tē shohim ndonjë njeri me tē meta	107
84-Çka duhet thënë në tubim	107
85-Duaja me rastin e përfundimit tē tubimit	108
86-Duaja për atë i cili tē thotë: gaferall-llahu leke	108
87-Duaja për atë i cili ta bën ndonjë tē mirë	109
88-Dhikri me tē cilin All-llahu tē mbron prej dexh-xhallit	109
89-Duaja për atë i cili tē thotë: inni uhibbuke fil-lah	109
90-Duaja për atë i cili tē ofron pasuri	110
91-Duaja e atij i cili tē ka borxh kur ta kthen atë	110
92-Duaja e frikës nga shirku	111
93-Duaja për atë i cili tē thotë: barekall-llahu fike	111
94-Duaja e urrejtjes së parashikimit tē keq	111
95-Duaja me rastin e ngjithës në mjetin e udhëtimit	112
96-Duaja e udhëtimit	113
97-Duaja e hyrjes në ndonjë fshat apo qytet	114
98-Duaja e hyrjes në treg	115
99-Duaja kur tē pengohet mjeti i udhëtimit	116
100-Duaja e udhëtarit për atë i cili nuk udhëton	116
101-Duaja e atij që nuk udhëton për udhëtarin	117
102-Tekbiri dhe tesbihu gjatë udhëtimit	117
103-Duaja e udhëtarit para agimit tē mëngjesit	118
104-Duaja kur tē ndalemi në ndonjë vend, qoftë në udhëtim	119
105-Duaja e kthimit nga udhëtimi	119
106-Ç`ka thotë ai tē cilët i vje një punë e cila e gjëzon	120
107-Vlera e përshtendetjes (salavatit) mbi Pejgamberin ﷺ	120
108-Përhapja e selamat	121
109-Si duhet kthyer selamin pabesimtarëve, nëse japid selam	122
110-Ç`duhet thënë kur tē këndon gjeli dhe tē pall gomari	123

111-Ç`duhet thënë kur tē lehin qentë natën	123
112-Duaja për atë tē cilin e ke ofenduar	123
113-Çka thotë muslimani kur ta lavdërojë muslimanin	124
114-Çka duhet tē thotë muslimani kur ta lavdërojë dikush	124
115-Telbia për haxhxh dhe umre	125
116-Tekbiri me rastin e afritmit tē haxherul-esvedit	125
117-Duaja ndërmjet ruknul-jemanit dhe haxherul-esvedit	125
118-Duaja e qëndrimit mbi Saffa dhe Merve	126
119-Duaja diutën e arefatit	127
120-Të përkujtuarit All-llahun te mesh 'aril-harami	127
121-Marrja e tekbireve për çdo gjuajtje	128
122-Duaja me rastin e dëgjimit tē ndonjë lajmi tē çuditshëm	128
123-Çka duhet tē veprojë ai tē cilit i ndodh diç që e gjëzon	129
124-Çka duhet tē thotë ai i cili ndien dhimbje në trupin e tij	129
125-Duaja e atij i cili frikohet se mos po qëllon diçka	129
126-Çka duhet thënë në raste tē frikës	130
127-Çka duhet thënë me rastin e therjes së kafshëve	130
128-Çka thuhet për largimin e kurthave tē shejtanëve	130
129-Të kërkuarit falje dhe pendimi	131
130-Vlera e tesbihut, tahmidit, tehlilit dhe e tekbit	133
131-Si bënte tesbih Pejgamberi	138
132-Disa punë tē mira dhe rregulla tē përgjithshme	138

Recensent :Ekrem Avdiu

Lektor : Zekerija Ibrahimë

Arlind Boshnjaku